

DATË 09.04.2026

PROCESVERBAL

**PËR ARGUMENTIMIN DHE MIRATIMIN E SPECIFIKIMEVE TEKNIKE DHE KRITEREVE
PËR KUALIFIKIM**

OBJEKTI I PROKURIMIT: “Ndërtim banese 6 kat dhe një kat parkim nëntokë në qytetin e Lushnjës.”

KODI PËRKATËS NË FJALORIN E PËRBASHKËT TË PROKURIMIT: Punime ndërtimi, 45210000-2

FONDI LIMIT: 129,938,916.77 (njëqind e njëzet e nëntë milion e nëntëqind e tridhjetë e tetë mijë e nëntëqind e gjashtëmbëdhjetë pikë shtatëdhjetë e shtatë) lekë pa TVSH.

KOHEZGJATJA E KONTRATES/MARREVESHJES KUADER OSE AFATI PER ZBATIMIN E SAJ : 16 (MUAJ)

Në bazë të nenit 21, pika 2, të Ligjit nr.162/2020 “Për prokurimin publik”, nenit 2, pika 2/c dhe nenit 78, pika 2, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, autoriteti/enti kontraktor **Operatori i Blerje të Përqëndruara sh.a.**, ka hartuar procesverbalin për argumentimin e kriterëve për kualifikim për procedurën e sipërcituar.

Sipas parashikimeve ligjore për procedurat të cilat realizohen nga Organi Qëndror Blerës, Specifikimet Teknike, Relacione, Projektet, Preventivi etj dhe llogaritja e Fondit Limit janë hartuar nga Autoriteti Kontraktor perfutues, i cili kërkon realizimin e punimeve.

4.4 Kriteret e përzgjedhjes së fituesit:

A) Oferta ekonomikisht më e favorshme, bazuar në kosto¹ X

Sipas rëndësisë:

Çmimi	pikët 60
Ngjashmeria e zerave te preventivave te kontratave te ngjashme me elemente te preventivit te procedures se prokurimit	pikët 20
Grafiku i punimeve	pikët 10
Periudha e garancisë se punimeve dhe paisjeve (jo më pak se 2 vjet)	pikët 10

1. Çmimi **[0 - 60] pikë**

Operatori ekonomik duhet të detajojë dhe përshkruajë ofertën e tij.

Pikët për këtë kriter përlllogariten sipas formulës:

¹Shënim. Të gjitha kriteret e vendosura për vlerësimin e ofertave duhet të jenë sa më objektive dhe të shprehesh në shifra. Në çdo rast, kur kriteret janë më shumë se një, pesha e kriterit të çmimit nuk do të jetë më pak se 50 pikë. Pikët maksimale që do të marrë një ofertë do të jenë 100 pikë.

$Pk1 = Vmink1 \times Pmaxk1 / Ok1$

Pk1 ____ Pikët e kriterit që vlerësohet.

Vmink1 ____ Vlera më e ulët e ofruar për kriterin që po vlerësohet.

Pmaxk1 ____ Pikët maksimale që i jepen kriterit që vlerësohet .

Ok1 Treguesi i ofertës për kriterin që vlerësohet.

Nëse një ose disa oferta vlerësohen si anomalisht të ulëta, refuzohen pa kërkuar shpjegime.

Argumentim: Kriteri i çmimit është përfshirë në dokumentet e tenderit si një nga elementët kryesorë të vlerësimit të ofertave, në përputhje me **nenin 87 të Ligjit nr. 162/2020 “Për prokurimin publik”**, i cili parashikon se autoriteti kontraktor mund të vlerësojë ofertat mbi bazën e **ofertës ekonomiksht më të favorshme, bazuar në kosto**. Përcaktimi i çmimit me **60 pikë** është bërë për të garantuar **efikasitetin e përdorimit të fondeve publike**, duke balancuar koston me cilësinë e elementëve të tjerë që janë përfshirë në vlerësim. Vlerësimi për këtë kriter është bërë në mënyrë proporcionale sipas formulës së përcaktuar në DST, duke siguruar **trajtimin e barabartë dhe konkurrencën e ndershme** ndërmjet operatorëve ekonomikë, në përputhje me **parimet e ligjit për prokurimin publik**.

2. Ngjashmeria e zerave të preventivave të kontratave të ngjashme me elemente të preventivit të procedurës së prokurimit [0-20 pikë]

Kontratat e ngjashme, të realizuara me sukses gjatë 5 viteve të fundit janë një kriter mjaft i rëndësishëm për të vlerësuar se një OE ka aftësi teknike, ekonomike dhe financiare për realizimin me sukses të kontratës. Zerat e preventivave të kontratave të ngjashme janë mjaft të rëndësishëm për të vlerësuar se cili OE mund ta realizojë me mirë në kohë dhe cilësi një kontratë. Zera të ngjashme apo të njëjta që janë realizuar me sukses orientojnë një OE i cili e ka me të lehtë për të realizuar në të ardhmen sesa një OE që nuk i ka zbatuar ndonjëherë zera të tilla. Për këto arsye vlerësimi me pike do të bëhet në mënyrë maksimale për ato OE që kanë zera me të ngjashme të kontratave të ngjashme me preventivin që prokurohet për punimet si më poshtë:

Pikët për këto nën-kritere përlogariten sipas formulës:

2.1 Punime betoni për konstruksionin e objektit në sasi jo më të vogël se 1200 m³ [0-10 pikë]

$Pk2.1 = Ok2.1 \times Pmaxk2.1 / Vmaxk2.1$

Pk2.1 ____ Pikët e kriterit që vlerësohet

Vmaxk2.1 ____ Vlera më e lartë e kriterit që vlerësohet (volumet e punimeve sipas nën-kriterit për zbatimin e kontratave me natyrë/kompleksitet të ngjashëm me kontratën e prokurimit)

Pmaxk2.1 ____ Pikët maksimale që i jepen kriterit që vlerësohet

Ok2.1__ Treguesi i ofertës për kriterin që vlerësohet

Permbushja e këtij kriteri do të provohet nëpërmjet situacioneve përfundimtare .

2.2 Punime hekur betoni në sasi jo më pak se 180 ton [0-10 pikë]

$Pk2.2 = Ok2.2 \times Pmaxk2.2 / Vmaxk2.2$

Pk2.2 ____ Pikët e kriterit që vlerësohet

Vmaxk2.2 ____ Vlera më e lartë e kriterit që vlerësohet (volumet e punimeve sipas nën-kriterit për zbatimin e kontratave me natyrë/kompleksitet të ngjashëm me kontratën e prokurimit)

Pmaxk2.2 ___ Pikët maksimale që i jepen kriterit që vlerësohet

Ok2.2__ Treguesi i ofertës për kriterin që vlerësohet

Permbushja e këtij kriteri do të provohet nepermjet situacioneve perfundimtare .

Argumentim: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar dhe nenit 39, pika 5 të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar. Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën.

Kontratat e ngjashme, të realizuara me sukses gjatë 5 viteve të fundit janë një kriter mjaft i rëndësishëm për të vlerësuar se një OE ka aftësi teknike, ekonomike dhe financiare për realizimin me sukses të kontratës. Zërat e preventivave të kontratave të ngjashme janë mjaft të rëndësishëm për të vlerësuar se cili OE mund ta realizojë me mirë në kohë dhe çilesi një kontratë. Zërat e ngjashëm apo të njëjtit që janë realizuar me sukses orientojnë një OE i cili e ka me të lehtë për të realizuar në të ardhmen sesa një OE që nuk i ka zbatuar ndonjëherë zërat e tillë. Për këtë arsye vlerësimi me pikë do të bëhet në mënyrë maksimale për ato OE që kanë zërat me të ngjashëm të kontratave të ngjashme me preventivin që prokurorët.

3. Grafiku i punimeve jo më shumë se 16 muaj

[0 – 10 pikë]

Operatori ekonomik mund të propozojë duke paraqitur një grafik të detajuar që argumenton kohën e propozuar për përfundimin e punimeve të kontratës. Operatori duhet të argumentojë (në mënyrë grafike) kohën e propozuar (**jo më shumë se 16 muaj**). Vlerësimi i pikëve për këtë kriter do të realizohet sipas përshkrimit të mëposhtëm:

$Pk3 = Vmink3 \times Pmaxk3 / Ok3$

Pk3 ___ Pikët e kriterit që vlerësohet

Vmink3 ___ Vlera më e ulët e ofruar për kriterin që po vlerësohet

Pmaxk3 ___ Pikët maksimale që i jepen kriterit që vlerësohet

Ok3 Treguesi i ofertës për kriterin që vlerësohet.

Argumentimi: Përfshirja e **grafikut të punimeve** si kriter vlerësimi është bërë në përputhje me **nenin 45 të VKM nr. 285/2021**, i cili parashikon se në rastet kur aplikohet metoda e “ofertës ekonomike më të favorshme – bazuar në kosto”, autoriteti kontraktor mund të vlerësojë **kushtet e dorëzimit**, duke përfshirë: datën e dorëzimit, procesin e dorëzimit, **periudhën e përfundimit të punimeve**, si dhe në nenin 87 të ligjit 162/2020 “Për prokurimin publik”

Ky kriter është përcaktuar me qëllim të **vlerësimit të kapacitetit organizativ dhe teknik të operatorit ekonomik**, për të ofruar realizimin e punimeve brenda një afati sa më optimal, pa çenuar cilësinë. Operatorët që paraqesin një **grafik të detajuar dhe të argumentuar të fazave të punimeve**, për një kohë më të shkurtër se kufiri maksimal i lejuar (jo më shumë se 16 muaj), pikëzohen më lart, duke reflektuar **efikasitet më të madh dhe organizim më të mirë teknik**.

4. Periudha e garancisë së punimeve dhe paisjeve (jo më pak se 2 vjet) [0–10 pikë]

Ky kriter garanton direkt dhe indirekt cilësinë e punimeve të kontraktorit, duke qënë se afatet më të gjata detyrojnë këtë kontraktor të kryejë punime me cilësi për mos të qenë i detyruar ti zëvendësojë apo riparojë punimet që do të kryeje. Referuar në nenin 45 të VKM nr.285/2021, kriteri i ofertës ekonomikisht më të favorshme bazohet në, kushtet e dorëzimit, si p.sh. datën e dorëzimit, procesin e dorëzimit dhe periudhën e dorëzimit ose periudhën e përfundimit.

Kontraktori do të garantojë cilësinë e punimeve minimalisht për 2 vjet. Çdo ofertë e paraqitur për më pak se dy vjet do të skualifikohet. Çdo ofertues i cili do të paraqesë një periudhë garancie punimesh për më shumë se 2 vjet do të vlerësohet si më poshtë:

Pikët për këtë kriter përlllogariten sipas formulës:

$$Pk4 = Ok4 \times Pmaxk4 / Vmax k4$$

$Vmaxk4$ _____ Vlera më e lartë e ofruar për kriterin që vlerësohet

$Pmaxk4$ _____ Pikët maksimale që i jepen kriterit që vlerësohet

$Ok4$ _____ Treguesi i ofertës për kriterin që vlerësohet.

Argumentimi: Përcaktimi i periudhës së garancisë së punimeve si kriter vlerësimi është bërë në përputhje me nenin 45 të VKM nr. 285/2021 “Për rregullat e prokurimit publik” si dhe në nenin 87 të ligjit 162/2020 “Per prokurimin publik”, i cili lejon përfshirjen në metodën e vlerësimit të ofertës ekonomikisht më të favorshme, të kriteve që lidhen me: kushtet e dorëzimit, procesin e dorëzimit, periudhën e dorëzimit, ose periudhën e përfundimit të punimeve.

Kriteri i garancisë është përzgjedhur me qëllim të nxitjes së cilësisë së lartë të punimeve, duke i dhënë përparësi operatorëve që ofrojnë një garanci më të gjatë, çka sjell:

- Siguri për autoritetin kontraktor se punimet janë të qëndrueshme,
- Përgjegjësi më të lartë nga kontraktori për të mos i rikthyer problematikat pas dorëzimit,
- Reduktim të kostove shtesë për mirëmbajtje të parakohshme.

Përcaktimi i afatit minimal të detyrueshëm prej 2 vitesh garanton një standard bazë ligjor dhe teknik, ndërsa pikëzimi diferencues për periudha më të gjata garancie përmirëson konkurrencën dhe motivon ofertuesit për të ofruar cilësi më të lartë.

Vlerësimi i këtij kriteri bëhet sipas formulës proporcionale të parashikuar në DST, në mënyrë që operatori me garancinë më të gjatë të marrë pikët maksimale (10 pikë), dhe të tjerët të pikëzohen në raport me të.

2. KRITERET E VEÇANTA TË KUALIFIKIMIT

1. Ofertuesi duhet të paraqesë:

a. Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit, sipas Shtojcës 8;

b. Sigurimin e Ofertës, sipas Shtojcës 3;

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme për sigurimin e ofertës mbështetet në Ligjin Nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik” (i ndryshuar), Neni 83, pika 1 si dhe në VKM Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” (e ndryshuar), Kreu V, Seksioni II, Neni 30, pika 1.

Kërkesa për Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit bazohet në Ligjin Nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik” (i ndryshuar), Neni 82 si dhe në VKM Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” (e ndryshuar), Kreu V, Seksioni II, Neni 26.

2. Ofertuesi duhet të paraqesë:

2.1. Përshtatshmëria për të kryer veprimtarinë profesionale (nëse është e aplikueshme):

Kjo pikë përmbushet sipas pikës 1/a) të Kriteve të Përgjithshme (*Vetëdeklarimi sipas shtojcës 8*)

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme bazohet në Nenin 77, pika 1/a dhe pika 2, të Ligjit Nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik” (i ndryshuar); si dhe Kreu V, Seksioni III, Neni 39, pika 6, të VKM-së Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” (e ndryshuar).

2.2 Kapaciteti ekonomik dhe financiar:

2.2.1 Kopje të deklarimit të xhiros vjetore gjatë 3 (tri) viteve të fundit financiare (2023, 2024, 2025) lëshuar nga Autoriteti përkatës, ku vlera e xhiros për të paktën një nga vitet e periudhës së kërkuar duhet të jetë jo më e vogël se vlera e përlogaritur e kontratës. Kjo kërkesë do të konsiderohet e përmbushur nëse Operatori ekonomik arrin vlerën e xhiros minimale në të paktën një vit të periudhës së kërkuar nga Autoriteti Kontraktor).

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në vlerën e fondit limit të kësaj procedure, si dhe bazuar në nenin 77, pika 3, e LPP, si dhe nenin 43, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar.

Kriteri i pikës 2.2.1 është vendosur referuar nenit 43, pika 2/c të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, ku është përcaktuar qartë vlera e kërkuar për xhiron minimale vjetore, dhe pikës 3 të nenit 77 të ligjit nr.162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar, si dhe Rekomandimit të APP-së nr 7998 date 24.12.2021. Vlera e kërkuar është brenda kufijve të vendosur në dispozitat më sipër, dhe është vendosur me qëllim që AK të sigurohet për potencialin ekonomik-financiar të OE ofertues, që lidhet drejtëpërdrejtë me qëndrueshmërinë dhe vijimësinë e veprimtarisë së operatorëve ekonomikë në treg, si një

element i rëndësishëm në realizimin e objektit të prokurimit dhe përmbushjes së detyrimeve kontraktore.

Përcaktimi i vlerës së kërkuar argumentohet si më poshtë:

Kjo vlerë për xhiron vjetore është kërkuar pasi vlera e parashikuar e kontratës, është ndërmjet kufirit të lartë dhe të ulët monetar.

Përcaktimi i viteve të kërkuara për paraqitjen e vërtetimit të xhiros vjetore është bërë duke iu referuar legjislacionit të fushës, konkretisht, nenit 43, pika 1, të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar. AK në vendosjen e këtij kriteri ka mbajtur në vëmendje nenin 61 të Ligjit nr.29/2023 "Për tatimin mbi të ardhurat" si dhe kërkesat e Ligjit nr. 25/2018 “Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare”.

2.2.2 Për të vërtetuar një aktivitet pozitiv të qëndrueshëm Operatori ekonomik duhet të paraqesë Kopje të çertifikuara të bilanceve të 3 (tri) viteve të fundit financiare (2023, 2024, 2025) të paraqitur në Autoritetet përkatëse Dega e Tatim Taksave të konfirmuara nga ky Autoritet si dhe të shoqëruara me Akt Ekspertizën e Ekspertit Kontabel të Autorizuar. (Kjo kërkesë do të konsiderohet e përmbushur nëse në dy bilancet e njëpasnjëshme të kërkuara, nuk ka raport negativ ndërmjet aktivitetit dhe pasivitetit).

Argumentim: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, pika 1 dhe 3, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” të ndryshuar; nenit 43, pika 4, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, të ndryshuar, si dhe në pikat 2 dhe 5 të nenit 61, të Ligjit nr.29/2023“Për tatimin mbi të ardhurat”, të ndryshuar ku përcaktohet se: “2 “*Deklarata tatimore vjetore dorëzohet në organin tatimor jo më vonë se data 31 mars e vitit pasardhës të vitit tatimor për të cilin dorëzohet deklarata*” dhe në pikën 5 përcaktohet se: “.....*Tatimpaguesit që mbajnë kontabilitet sipas kërkesave të ligjit përkatës, paraqesin deklaratën vjetore së bashku me pasqyrat financiare, si dhe të dhëna të tjera të përcaktuara në udhëzimin e ministrit përgjegjës për financat për zbatimin e këtij ligji.*”, si dhe kërkesave të ligjit Nr. 25/2018 “Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare” të ndryshuar dhe nenit 14 të Nr. 10 091, datë 5.03.2009 “Për auditimin ligjor, organizimin e profesionit të audituesit ligjor dhe të kontabilistit të miratuar” të ndryshuar.

Në pikën 1 të nenit 77 të LPP përcaktohet se: “1. *Autoritetet ose entet kontraktore përcaktojnë kërkesat për kualifikim për operatorët ekonomikë bazuar në: a) përshtatshmërinë për të kryer veprimtarinë profesionale; b) gjendjen ekonomike dhe financiare; c) aftësinë teknike dhe profesionale. Kërkesat kufizohen vetëm në ato që janë të përshtatshme për të garantuar që një kandidat ose ofertues të ketë kapacitetet juridike, financiare dhe aftësitë teknike e profesionale për të zbatuar kontratën që do të jepet. Të gjitha kërkesat duhet të kenë lidhje dhe të jenë proporcionale me objektin e kontratës.*” dhe në pikën 3 të tij përcaktohet se: “3. *Në lidhje me situatën ekonomike dhe financiare, autoritetet ose entet kontraktore mund të vendosin kërkesa që garantojnë se operatorët ekonomikë kanë kapacitetin e nevojshëm ekonomik dhe financiar për të zbatuar kontratën. Për këtë qëllim autoritetet ose entet kontraktore mund të kërkojnë në veçanti që operatorët ekonomikë të kenë një xhiro vjetore minimale të caktuar. Gjithashtu, autoritetet ose entet kontraktore mund të kërkojnë që operatorët ekonomikë të japin informacione në bilancet e tyre vjetore që të tregojnë raportet ndërmjet aktivitetit dhe pasivitetit. Xhiroja vjetore minimale që kërkohet nga operatorët ekonomikë nuk mund të tejkalojë dyfishin e vlerës së parashikuar të kontratës. Kur një kontratë ndahet në lote, ky nen zbatohet për çdo lot individual. Megjithatë, autoriteti ose enti kontraktor mund të përcaktojë xhiron vjetore minimale që u kërkohet operatorëve, duke iu referuar grupeve të loteve, në rast se ofertuesi i suksesshëm merr disa lote që duhet të zbatohen në të njëjtën kohë. Në rastin e kontratave që bazohen në një marrëveshje kuadër, kërkesa për xhiron minimale llogaritet mbi bazën e përmasave maksimale të kontratave specifike që do të*

zbatohen në të njëjtën kohë ose, kur përmasat nuk dihen, mbi bazën e vlerës së parashikuar të marrëveshjes kuadër.”

Në nenit 43, pika 4, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 të ndryshuar përcaktohet se: “4. Nëse vlerësohet, autoriteti/enti kontraktor mund të kërkojë që operatorët ekonomikë të japin informacione në bilancet e tyre vjetore, për një periudhë maksimumi tre vitet e fundit financiare, që të tregojnë raportet, ndërmjet aktivitetit dhe pasivitetit. Nëse kërkohen një ose dy bilance, kërkesa konsiderohet e përmbushur nëse në bilancin/et e kërkuara nuk ka raport negativ ndërmjet aktivitetit dhe pasivitetit. Nëse kërkohen bilance të tre viteve të fundit, kërkesa konsiderohet e përmbushur nëse në dy bilancet e njëpasnjëshme të kërkuara, nuk ka raport negativ ndërmjet aktivitetit dhe pasivitetit.”

Në nenit 41, të ligjit nr.10091, datë 05.03.2009 “Për auditimin ligjor, organizimin e profesionit të audituesit ligjor dhe të kontabilistit të miratuar” të ndryshuar, përcaktohet se: “Detyrohen të kryejnë auditimin ligjor të pasqyrave financiare vjetore, individuale apo të konsoliduara, përpara publikimit të tyre: a) të gjitha njësitë ekonomike dhe grupet e njësisve ekonomike me interes publik; b) të gjitha njësitë ekonomike dhe grupet e njësisve ekonomike, të cilat në mbyllje të periudhës kontabël, për dy vjet radhazi, tejkalojnë dy prej tre treguesve të mëposhtëm: i. totali i aktiveve të bilancit në mbyllje të periudhës kontabël përkatëse arrin ose e kalon shumën prej 50 000 000 (pesëdhjetë milionë) lekësh; ii. shuma e të ardhurave nga veprimtaria ekonomike (qarkullimi) në atë periudhë kontabël arrin ose e kalon shumën prej 100 000 000 (njëqind milionë) lekësh; iii. ka mesatarisht të paktën 50 (pesëdhjetë) të punësuar gjatë periudhës kontabël.”

Me anë të këtij kriteri, për paraqitjen e bilanceve të tre viteve të fundit financiare, është vendosur duke pasur në konsideratë objektin e kontratës, natyrën dhe volumin e saj, vlerën e fondit limit, më qëllim që t'i shërbejnë autoritetit kontraktor për njohjen e gjendjes dhe kapaciteteve të operatorit ekonomik, të cilët duhet të vërtetojnë se zotërojnë kapacitetet e nevojshme ekonomike dhe financiare, gjithçka në funksion të realizimit me sukses të kontratës.

Dorëzimi i bilanceve kontabël të konfirmuar nga autoritet tatimore kërkohet për të dëshmuar se kopja e bilancit të paraqitur në këtë procedurë prokurimi është kopje e njëjtë me atë të paraqitur pranë administratës tatimore.

2.3 Kapaciteti teknik:

Përsa i përket aftësisë teknike e profesionale, Operatori Ekonomik duhet të përmbushë kërkesat e mëposhtme minimale të cilat vendosen nga Autoriteti Kontraktor si më poshtë:

2.3.1 Përvojë e suksesshme në realizimin e të paktën:

- a. Punë të ngjashme për një objekt të vetëm me vlerë jo më të vogël se **50%** e vlerës së përlllogaritur të kontratës që prokurohet konkretisht: **64,969,458.39** (gjashtëdhjetë e katër milion e nëntëqind e gjashtëdhjetë e nëntë mijë e katërqind e pesëdhjetë e tetë pikë tridhjetë e nëntë) lekë pa TVSH, të realizuar gjatë pesë viteve të fundit nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës.
- b. Punë të ngjashme deri në një kufi ku vlera monetare totale e punëve të kryera e marrë së bashku gjatë pesë viteve të fundit është në një vlerë jo më të vogël sa dyfishi i vlerës limit të kontratës që prokurohet konkretisht: **259,877,833.54** (dyqind e pesëdhjetë e nëntë milion e tetëqind e shtatëdhjetë e shtatë mijë e tetëqind e tridhjetë e tre pikë pesëdhjetë e katër) lekë pa TVSH.

Plotësimi i njerit prej dy kushteve te siperpermendura e bën oferten të kualifikueshme.

Pika 1/a plotësohet nga anëtari i cili ka përqindjen më të madhe të pjesëmarrjes në bashkim. Anëtarët e tjerë të bashkimit do të paraqesin kontratat e ngjashme në raport me përqindjen e pjesëmarrjes së tyre në bashkim. Kurse pika 1/b duhet të plotësohet nga të gjithë anëtarët e bashkimit në raport me përqindjen e pjesëmarrjes së tyre në bashkim. Në rastin kur Operatorët ekonomik, anëtarë të një bashkimi, kanë të njëjtën përqindje pjesëmarrjeje në bashkim, vendosin me marrëveshje në Kontratën e Bashkëpunimit se cili prej tyre do ta përmbushë këtë kusht.

1. Vlerësimi i përvojës së suksesshme të Operatorit Ekonomik do të kryhet bazuar në deklaratat e dokumentat e mëposhtme:

- a) Për kontrata të realizuara me ente publike, Operatori ekonomik duhet të paraqesë dokumentacionin e mëposhtëm:
 - Formular vlerësimi për realizimin e punimeve sipas shtojcës Nr.9 (ku të përcaktohet qartazi vlera, afati i përfundimit të kontratës si dhe natyra e punës së kryer);
 - Kontratë Sipërmarrje;
 - Situacionin përfundimtar;
 - Aktin e kolaudimit;
 - Çertifikatën e marrjes në dorezim/Çertifikatën e Përkohshme të marrjes në dorezim.

Autoriteti/enti kontraktor, si dëshmi për përvojën e mëparshme, kërkon vërtetime të lëshuara nga një ent publik, për përmbushjen me sukses të kontratës, ku të shënohen vlera, afati i përfundimit të kontratës dhe natyra e punës së bërë, për të vërtetuar përmbushjen e suksesshme të punëve.

Shënim: *Formulari i vlerësimit duhet të përcaktojë saktësisht cilësinë e kryerjes së punëve, dhe faktin nëse kontrata është realizuar me sukses.*

- b) Për kontrata të realizuara me sektorin privat, Operatori ekonomik duhet të paraqesë dokumentacionin e mëposhtëm:
 - Kontratë Sipërmarrje
 - Situacionin përfundimtar;
 - Fatura tatimore perkatese të deklaruara në organet tatimore.
 - Aktin e kolaudimit;

Në rastin e përvojës së mëparshme të realizuar me sektorin privat, autoriteti/enti kontraktor kërkon si dëshmi, vërtetime, për përmbushjen me sukses të kontratës, ku të shënohen vlera, afati i përfundimit të kontratës dhe natyra e punës së bërë, e shoqëruar me fatura tatimore dhe çdo lloj dokumenti tjetër, që parashikohet nga legjislacioni në fuqi, që provon realizimin me sukses të punëve.

Shënim: *Formulari i vlerësimit duhet të përcaktojë saktësisht cilësinë e kryerjes së punëve, dhe faktin nëse kontrata është realizuar me sukses.*

- 1.1** Për kontratat e realizuara si Bashkim Operatorësh, Operatori ekonomik ofertues duhet të paraqesë: Kontratën e Bashkimit të operatoreve ekonomik si dhe prokurën e posacme të deklaruar në fazën e tenderimit.
- 1.2** Për kontratat e realizuara si Nënkontraktor, Operatori ekonomik ofertues duhet të paraqesë: Kontratën bazë ndërmjet Kontraktorit dhe Autoritetit Kontraktor; si dhe Miratimi zyrtar si nënkontraktor i deklaruar nga ana e autoritetit kontraktor.

Argumentimi: Përvoja e suksesshme si dhe vlerësimi i saj u hartua duke iu referuar Nenit 77, pika 4 të Ligjit Nr. 162, datë 23.12.2020 “Për Prokurimin Publik” si dhe bazuar në Nenin 39, pika 5, të VKM Nr. 285, datë

19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të Prokurimit Publik”. Me anë të këtij kriteri kërkohet që Operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën, prandaj është kërkuar që:

a. Punë të ngjashme për një objekt të vetëm me vlerë jo më të vogël se 50% e vlerës së përllogaritur të kontratës që prokurohet konkretisht: 64,969,458.39 (gjashtëdhjetë e katër milion e nëntëqind e gjashtëdhjetë e nëntë mijë e katërqind e pesëdhjetë e tetë pikë tridhjetë e nëntë) lekë pa TVSH, të realizuar gjatë pesë viteve të fundit nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës.

b. Punë të ngjashme deri në një kufi ku vlera monetare totale e punëve të kryera e marrë së bashku gjatë pesë viteve të fundit është në një vlerë jo më të vogël sa dyfishi i vlerës limit të kontratës që prokurohet konkretisht: 259,877,833.54 (dyqind e pesëdhjetë e nëntë milion e tetëqind e shtatëdhjetë e shtatë mijë e tetëqind e tridhjetë e tre pikë pesëdhjetë e katër) lekë pa TVSH.

Plotesimi i njerit prej dy kushteve të sipërpermendura e bën ofertën të kualifikueshme.

Pika 1/a plotësohet nga anëtari i cili ka përqindjen më të madhe të pjesëmarrjes në bashkim. Anëtarët e tjerë të bashkimit do të paraqesin kontratat e ngjashme në raport me përqindjen e pjesëmarrjes së tyre në bashkim. Kurse pika 1/b duhet të plotësohet nga të gjithë anëtarët e bashkimit në raport me përqindjen e pjesëmarrjes së tyre në bashkim.

Në rastin kur Operatorët ekonomik, anëtarë të një bashkimi, kanë të njëjtën përqindje pjesëmarrjeje në bashkim, vendosin me marrëveshje në Kontratën e Bashkëpunimit se cili prej tyre do ta përmbushë këtë kusht.

Gjithashtu referuar VKM-së Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të Prokurimit Publik”, Kreu XI, Neni 88, pika 3 citohet se: *“Kur oferta paraqitet nga një bashkim operatorësh, kushti i përcaktuar në shkronjën “a”, të pikës 5, të nenit 39, të këtyre rregullave, plotësohet nga anëtari, i cili ka përqindjen më të madhe të pjesëmarrjes në bashkim. Anëtarët e tjerë të bashkimit do të paraqesin kontratat të ngjashme, në raport me përqindjen e pjesëmarrjes së tyre në bashkim. Në rastin kur operatorët ekonomikë, anëtarë të një bashkimi, kanë të njëjtën përqindje pjesëmarrjeje në bashkim, vendosin me marrëveshje në kontratën e bashkëpunimit se cila prej tyre do të përmbushë këtë kusht.”* AK argumenton se Puna e ngjashme është kërkesë, e cila shërben për të vlerësuar përvojën e duhur të Ofertuesve. Vlerësimi i përvojës realizohet duke paraqitur dokumentat e kërkuara sipas pikave (1.a – 1.b), të cilat vërtetojnë eksperiencën në realizimin e punëve publike të ngjashme, si dhe janë një garanci më shumë për Autoritetin Kontraktor me qëllim përmbushjen me sukses të kontratës objekt prokurimi. Përvoja e sukseshme si dhe vlerësimi i saj është hartuar duke iu referuar Nenit 77, pika 4 të Ligjit Nr. 162, datë 23.12.2020 “Për Prokurimin Publik” ku qartazi përcaktohet se: *“Në lidhje me aftësitë teknike dhe profesionale, autoritetet ose entet kontraktore mund të vendosin kërkesa që garantojnë se operatorët ekonomikë zotërojnë burimet e nevojshme njerëzore e teknike, si dhe përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën sipas një standardi të përshtatshëm cilësie.*

Autoritetet ose entet kontraktore, në veçanti, mund të kërkojnë që operatorët ekonomikë të kenë një nivel të mjaftueshëm përvoja që vërtetohet nga referenca të përshtatshme nga kontratat e zbatuara në të shkuarën.

Aftësia profesionale e operatorëve ekonomikë për të ofruar shërbimin, punën, mallin vlerësohet në lidhje me aftësitë organizative, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm për të zbatuar kontratën, siç është përshkruar nga autoriteti ose enti kontraktor në njoftimin e objektit të kontratës.”, si dhe bazuar në Nenin 39, pika 5, të VKM Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të Prokurimit Publik”, ku përcaktohet se: *“Për të provuar përvojën e mëparshme, autoriteti/enti kontraktor kërkon: a) punë të ngjashme për një objekt të vetëm në një vlerë jo më të madhe se 50% e vlerës së përllogaritur të kontratës që prokurohet dhe që është realizuar gjatë pesë viteve të fundit, nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës; b) punë të ngjashme deri në një kufi, ku vlera monetare totale e punëve të kryera, e marrë së bashku gjatë pesë viteve të fundit, është jo më e madhe se dyfishi i vlerës limit të kontratës që prokurohet. Plotësimi i njerit prej dy kushteve të sipërpermendura e bën ofertën të kualifikueshme. Autoriteti/enti kontraktor, si dëshmi për përvojën e*

mëparshme, kërkon vërtetime të lëshuara nga një ent publik, për përmbushjen me sukses të kontratës, ku të shënohen vlera, afati i përfundimit të kontratës dhe natyra e punës së bërë, për të vërtetuar përmbushjen e suksesshme të punëve. Në rastin e përvojës së mëparshme të realizuar me sektorin privat, autoriteti/enti kontraktor kërkon si dëshmi, vërtetime, për përmbushjen me sukses të kontratës, ku të shënohen vlera, afati i përfundimit të kontratës dhe natyra e punës së bërë, e shoqëruar me fatura tatimore dhe çdo lloj dokumenti tjetër, që parashikohet nga legjislacioni në fuqi, që provon realizimin me sukses të punëve.”.

AK argumenton se Puna e ngjashme është kërkesë, e cila shërben për të vlerësuar përvojën e duhur të Ofertuesve. Vlerësimi i përvojës realizohet duke paraqitur dokumentat e kërkuara sipas pikave (1.a – 1.b), të cilat vërtetojnë eksperiencën në realizimin e punëve publike të ngjashme, si dhe janë një garanci më shumë për Autoritetin Kontraktor me qëllim përmbushjen me sukses të kontratës objekt prokurimi. Sqarojmë se nga praktika, gjatë fazes së vlerësimit të ofertave, AK ka hasur vështirësi në vlerësimin në mënyrë sa me të drejte të përvojës së ngjashme, pasi jo të gjitha institucionet shtetërore apo private leshojnë Formularin e Vlerësimit sipas formatit zyrtar (ku përcaktohet ndarja e perqindjeve). Në kuadër të vlerësimit të ofertave në mënyrë sa me të drejte, duhet që në rastet e BOE apo Nenkontraktimit, vlerësimi i përvojës të vërtetohet me paraqitjen e kontratës së bashkëpunimit; me marrëveshjen e nenkontraktimit si dhe me aktin e miratimit të nenkontraktimit lëshuar nga Institucioni. Ky dokumentacion disponohet nga çdo OE si në rastin kur ka qene pale në Bashkimin e OE ashtu dhe në rastet kur ka qene Nenkontraktor. Ky dokumentacion është lehtësisht i aksesueshëm dhe është pjesë e dosjes së zbatimit të punimeve të kontratës që duhet ta ketë çdo kompani në dosjen e saj, për rrjedhojë nuk mund të sjellë kufizim të pjesmarrjes së OE në tender as në mënyrë direkte dhe as në mënyrë indirekte.

Gjykojmë që kërkesa e mësipërme nuk është në kundërshtim me asnjë nga dispozitat ligjore që parashikohen nga legjislacioni i prokurimit publik. Gjithashtu vendos në kushte të barabarta dhe u jep mundësi të gjithë OE Ofertues edhe në ato rastet kur Formularët e Vlerësimit mund të jenë të paplotesuara sipas standartit.

AK ka kërkuar këto dokumenta në përputhje me parashikimet e Nenit 39, pika 5, të VKM Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të Prokurimit Publik”, ku ndër të tjera përcaktohet se: *”Në rastin e përvojës së mëparshme të realizuar me sektorin privat, autoriteti/enti kontraktor kërkon si dëshmi, vërtetime, për përmbushjen me sukses të kontratës, ku të shënohen vlera, afati i përfundimit të kontratës dhe natyra e punës së bërë, e shoqëruar me fatura tatimore dhe çdo lloj dokumenti tjetër, që parashikohet nga legjislacioni në fuqi, që provon realizimin me sukses të punëve.”.*

2.3.2 Liçensa profesionale, lidhur me ekzekutimin e punëve të kontratës:

Operatorët ekonomikë duhet të paraqesin licencën profesionale të shoqërisë, të vlefshme për zbatimin e punimeve objekt kontrate, të lëshuar nga Ministria e Infrastrukturas dhe Energjisë, në bazë të VKM nr. 42 datë 16.01.2008, Për miratimin e rregullores për kriteret dhe procedurat e dhënies së licencave profesionale të zbatimit, klasifikimit dhe disiplinimit të subjekteve juridike që ushtrojnë veprimtari ndërtimi” të ndryshuar, e cila përfshin kategoritë e mëposhtme:

Për punimet e përgjithshme në ndërtim :

- **NP-1A** Punime germimi në tokë.
- **NP-2C** Ndërtime civile dhe industriale.
- **NP-7A** Ujesjelles,kanalizime, vepra kullimi dhe vaditje.
- **NP-12A** Punime të inxhinierisë së mjedisit.

Për punimet speciale të ndërtimit :

- **NS-2A** Impiante hidrosanitare, kuzhina, lavanteri, mirëmbajtja e tyre
- **NS-3A** Impiante ngritëse dhe transportuese (ashensorë, shkallë lëvizëse, transportues).
- **NS-4B** Punime rifiniture të muraturës dhe të lidhura me to, rifiniture me materiale druri, plastike, metalike dhe xhami dhe rifiniture të natyrës teknike ndërtuese.
- **NS-9A** Punime strukturore speciale
- **NS-14A** Impiante te brendshme elektrike,telefonike,radiotelefoni TV
- **NS-18A** Punime Topogjeodezike

Operatorët e huaj duhet të bëjnë ekuivalentimin e licensave profesionale që disponojnë të lëshuara nga vendi i origjinës, pranë Ministrisë së Infrastrukturës dhe Energjisë, (ose Ministrisë kompetente të kohës) Republika e Shqipërisë. (Rregullorja për kriteret dhe procedurat e dhënies së licensave profesionale te zbatimit, klasifikimit dhe disiplinimit të subjekteve juridike që ushtrojnë veprimtari ndërtimi, e miratuar me VKM- në, Nr.42, datë 16.01.2008). Mosparaqitja në këtë formë është kusht skualifikues.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, nenin 39, pika 6/a, të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, i ndryshuar si dhe Vendimin e Keshillit të Ministrave Nr. 42 datë 16.01.2008 “Për miratimin e rregullores për kriteret dhe procedurat e dhënies së licensave profesionale të zbatimit, klasifikimit dhe disiplinimit të subjekteve juridike që ushtrojnë veprimtari ndërtimi”, i ndryshuar. Të dhënat për licencat e mësipërme janë vendosur referuar bazës ligjore për ndërtimet, ligjit nr. 8402 datë 10.9.1998 “Për kontrollin dhe disiplinimin e punimeve të ndërtimit” të ndryshuar, neni 8 përcakton "Zbatimi i punimeve të ndërtimit kryhet vetëm nga persona juridikë, privatë ose publikë, vendas ose të huaj, të pajisur me licencën përkatëse, për zbatim punimesh ndërtimore. Zbatuesi i punimeve mban përgjegjësi dhe është i detyruar të realizojë punimet e ndërtimit, në përputhje me lejen e ndërtimit, projektin, kushtet teknike të zbatimit dhe rregullat e sigurimit teknik. Ai duhet të sigurojë cilësinë e materialeve të ndërtimit dhe produkteve të ndërtimit, të cilat duhet të plotësojnë kërkesat e projektit në përputhje me standartet kombëtare ose europiane. Referuar kategorive të kërkuara, AK argumenton teknikisht se kjo kërkesë është vendosur sipas zërave të preventivit të punimeve.

-Kategoritë janë kërkuar bazuar në zërat dhe vlerat e punimeve, si më poshtë:

Kategoria e kërkuar	Përshkrimi i kategorisë sipas legjislacionit të fushës	Zërat e punimeve që parashikohen të kryhen në preventiv, që përfshihen në kategorinë përkatëse	Niveli i klasifikimit i kërkuar për kategorinë respektive
NP-1A	Punime germimi ne toke	Germim dheu themele e plinta me b>2m, ekskavator me goma 0.25m ³ ,shkarkimi ne auto Germim e mbushje dheu me krah per kanale kategori III, h=1.5m Hedhje,rrafshim,mbushje dheu me krah, kategoria III Transport dheu me auto deri 5.0 km	A (0- 20 milionë lekë)

NP-2 C	Ndërtime civile dhe industriale	<p>Struktura monolite betoni C 25/30</p> <p>Pllake themeli, trare e bazamente b/a C 25/30</p> <p>Pllake themeli, trare e bazamente b/a C 20/25</p> <p>Kollona b/a monolite C 25/30 h ~ 4m</p> <p>Trare e arkitrare b/a C20/25 h ~ 4m</p> <p>Soleta te plota b/a C 20/25 t = 10 cm, h ~ 4m</p> <p>Mure b/a t = 21-30cm, h ~ 4m C 20/25</p> <p>Brez b/a C20/25</p> <p>F.V. Hekur betoni periodik Ø 6 - 10 mm</p> <p>F.V. Hekur betoni periodik Ø > 12 mm</p> <p>F.V. Konstruksione metalike te thjeshta.</p> <p>Mur me tulla te lehtesuara dopio deri 8 m, LL.P. M-25</p> <p>Mur me tulla me 8 vrima, t=10cm h~3m, ll perz M 15</p> <p>Ndetim muri me gips t=10cm me dy shtresa</p> <p>Suva brenda mur tulle ~ 4m, me pompe, ll perzier M 25</p> <p>Suva solete ~ 4 m, me drejtues, me pompe</p> <p>Veshje fasade me polisterol t=5cm + rrjete + suva.</p> <p>Plintuse pllake grez</p> <p>Veshje me pllake majolike</p> <p>Mbushje me material te germuar ne trupin e rruges, perhapur e ngjeshur me makineri</p> <p>Shtrese rere natyrore t=20cm</p> <p>Shtrese zhavori</p> <p>Shtrese avullizoluese gjeotekstil</p> <p>Shtrese me pllaka grez porcelanato</p> <p>Trotuar me pllaka, pa borduren e betonit</p> <p>Bordura trotuari 25x12cm derdhur ne vend</p> <p>Shtrese betoni C 12/15</p> <p>Shtrese me pllaka mermeri t=3cm</p> <p>Shtrese termoizoluese me polisterol t=10 cm</p> <p>Shtrese lluster cemento 1:2 t = 20 mm</p> <p>Hidroizolim me emulsion bitumi dhe 2 k katrama</p> <p>Lyerje betoni me astar me baze poliuretani</p> <p>Hidroizolim me emulsion bitumi dhe 1 k katrama</p> <p>Hidroizolim me emulsion dhe 2 bitum</p>	C (51-100 milionë lekë)
--------	---------------------------------	--	----------------------------

		<p>F.V. Dyer te brendeshme tamburate te rimesuara</p> <p>Dyer te blinduara</p> <p>F.V. Dyer te brendeshme metalike te blinduara.</p> <p>F.V. Dyer metalike llamarine</p> <p>F.V. Dritare d/alumini plastike me dopio xham</p> <p>F.V. Dyer d/alumini plastike me dopio xham</p> <p>Boje hidroplastike</p> <p>Boje vaji sipërfaqe metalik</p> <p>Solete monolite b/a me tulle te lehtësuar t=30cm</p> <p>Shtrese mbrojtëse podrumi me polisterol t=5cm</p> <p>F.V. Qepen llamarine</p> <p>Parapet shkallë të jashtme e të brendshme me hekur h=80-90cm etj</p>	
NP-7 A	Ujesjelles,kanalizime, vepra kullimi dhe vaditje	<p>Mbushje me zhavorr pas mureve</p> <p>F.V. Tub drenazhi Ø 150 mm</p> <p>Pusete shkarkimi 80 x 80, h = 150 cm</p> <p>F.V. Tuba te brinjezuar HDPE SN8 d=400 mm</p> <p>F.V. Tuba te brinjezuar HDPE SN8 d=315 mm</p>	A (0- 20 milionë lekë)
NP-12A	Punime të inxhinierisë së mjedisit.	<p>Punimet per ndertimin e objektit kane impakt mjedisor</p> <p>ne te gjithë zonen perreth saj duke pasur parasysh</p> <p>pozicionimin e saj ne zone e banuar urbane , sasine e madhe te mbetjeve te gjeneruara nga punimet e prishjeve dhe germimeve , për menaxhimin e punime të ujrave të ndotura etj duke ju permbajtur VNM .Bazuar ne ligji nr. 10431, datë 9.6.2011 "Për mbrojtjen e mjedisit" (i ndryshuar).</p>	A (0- 20 milionë lekë)
NS-2A	Impiante hidrosanitare, kuzhina, lavanteri, mirëmbajtja e tyre	<p>F.V. Tuba e rakorderi ujesjellesi PE d=50mm, t = 5.6 mm, Pn 20</p> <p>F.V. Tuba e rakorderi ujesjellesi PE d=25mm, t = 3.0 mm, Pn 20</p> <p>F.V. Tuba e rakorderi ujesjellesi PE d=20mm, t = 2.3 mm, Pn 20</p> <p>Termoizolim tubi Ø 1/2" me armofleks (d22x9)</p>	A (0- 20 milionë lekë)

		<p>F.V. Saracineska bronzi Ø 3/4 " = 20 mm</p> <p>F.V. Rezervuari zingato 5000 litra</p> <p>F.V. Saracineska bronzi Ø 1 1/2 " = 40 mm</p> <p>F.V. Saracineska bronzi Ø 2 " = 50 mm</p> <p>F.V. Pilete dysHEMEJE Ø 50</p> <p>F.V. WC allafrenga</p> <p>F.V. Lavaman porcelani</p> <p>F.V. Tuba çeliku i zi</p> <p>F.V. Tub kanalizimi pvc Ø 110</p> <p>F.V. Tuba fleksibël DN 1/2"</p> <p>F.V Filtër Mekanik prej Bronzi Ø 2 "</p> <p>F.V Kundravalvol bronzi Ø 2 "</p> <p>Kolektor shpërndarës i ujit sanitar, prej tubacioni çeliku të galvanizuar, për masë DN50 (1 1/2", gjatësi 2.5m, 15 dalje 3/4")</p> <p>Kundravalvul Ø 3/4 "</p> <p>FV Galexhant mekanik 1 1/2"</p> <p>F.V. Grup Presioni i Ujit të Pijshëm, komandim inverter i shpejtësisë: Q = 6,5 m³/h; P (H) = 4.0 bar (≈ 40 m)</p> <p>F.V. Tuba HDPE të Brinjuara SN 4 Dj 200 x 14 mm</p> <p>F.V. Tuba dhe Rakorderi PP Dj 125 mm</p> <p>F.V. Tuba dhe Rakorderi PP Dj 110 mm</p> <p>F.V. Tuba dhe Rakorderi PP Dj 75 mm</p> <p>F.V. Tuba dhe Rakorderi PP Dj 50 mm</p> <p>F.V. Pika Kontrolli PP Dj 110 mm</p> <p>F.V. Pika Kontrolli PP Dj 125 mm</p> <p>F.V pllakë dushi porcelani 100x100</p> <p>F.V. Tuba dhe Rakorderi PP Dj 250 mm</p> <p>F.V. Tuba dhe Rakorderi PP Dj 200 mm</p> <p>F.V. Tuba dhe Rakorderi PP Dj 160 mm</p> <p>F.V. Tuba dhe Rakorderi PP Dj 125 mm</p> <p>F.V. Ventilatorë Aksialë për banja Q = 150 m³/orë</p> <p>Valvol moskthimi Ø125mm</p> <p>Tub ventilimi i kapave të kuzhinave, llamarinë celiku e galvanizuar, diam. Ø125mm</p> <p>Tub ventilimi ë kapave të kuzhinave, llamarinë celiku e galvanizuar, diam. Ø160mm</p>	
--	--	---	--

		<p> Tub ventilimi i kapave të kuzhinave, llamarinë celiku e galvanizuar, diam. Ø200mm F.V. Pileta tarrace PE/ABS me kapak tip rrjete konike 150 x 150 mm; dalje vertikale/horizontale Dj 110 mm F.V. Tuba HDPE të Brinjuara Dj 250mm F.V. Pusetë në këmbën e kolektorit vertikal te ujit të shiut F.V. Pusetë e pompës zhytëse b/a e konstruktuar në vend, përmasë 120cmx120cm, H=310cm, me kapak gize Montim Elektropompë zhytëse, Q=200l/min, H=4m F.V. Kuretë e mbledhjes së ujit të shiut, me zgare metalike për mbulim, përmasë 25x21x310cm Montim Hidrante Zjarri Ø 1 1/2 ", L = 20 m Montim Fikse zjarri portabel me pluhur, 6kg, tipi 34A 233BC Montim Fikse zjarri portabel me pluhur, 9kg, tipi 55A 233BC Montim Fikse zjarri portabel me CO2, 5kg, tipi 113B, per ambjentin e kabines elektrike V.Grup saraçineske me 1 Gryke lidhje hidranti 2 1/2" për brigadat MNZ Montim Grup Presioni i Sistemit Kundrazjarrit (Pompë Elektrike + Pompë me motor Diezel + pompë pilot - jockey pump) Q = 20 m³/h; P (H) = 5.0 bar (50 m), Q pilot = 4 m³/h; P (H) = 5.5 bar (55 m) F. Grup Presioni i Ujit të Pijshëm, komandim inverter i shpejtësise: Q = 6,5 m³/h; P (H) = 4.0 bar (≈ 40 m) Elektropompë zhytëse, Q=200l/min, H=4m Hidrante Zjarri Ø 1 1/2 ", L = 20 m Fikse zjarri portabël me pluhur, 6kg, tipi 34A 233BC Fikse zjarri portabël me pluhur, 9kg, tipi 55A 233BC F.Grup saracineske me 1 gryke lidhje hidranti 2 ½ per MNZ F.grup i lidhjes së motopompës me brigadat MNZ </p>	
--	--	---	--

		Fikse zjarri portabël me CO2, 5kg, tipi 113B, për ambientin e kabinës elektrike F. Grup Presioni i Sistemit Kundrazjarrit (Pompë Elektrike + Pompë me motor Diezel + pompë pilot - jockey pump) Q = 20 m³/h; P (H) = 5.0 bar (50 m), Q pilot = 4 m³/h; P (H) = 5.5 bar (55 m) .	
NS-3A	Impiante ngritëse dhe transportuese (ashensorë, shkallë lëvizëse, transportues).	Montim Ashensori F.Ashensorë	A (0- 20 milionë lekë)
NS-4B	Punime rifiniture të muraturës dhe të lidhura me to, rifiniturë me materiale druri, plastik, metalik dhe xhami dhe rifiniturë të natyrës teknike ndërtuese.	Mur me tulla te lehtësuara dopio deri 8 m, LL.P. M-25 Mur me tulla me 8 vrima, t=10cm h~3m, ll perz M 15 Ndetim muri me gips t=10cm me dy shtresa Suva brenda mur tulle ~ 4m, me pompe, ll perzier M 25 Suva solete ~ 4 m, me drejtues, me pompe Veshje fasade me polisterol t=5cm + rrjete + suva. Plintuse pllake grez Veshje me pllake majolike Shtrese zhavori Shtrese avullizoluese gjeotekstil Shtrese me pllaka grez porcelanato Trotuar me pllaka, pa borduren e betonit Bordura trotuari 25x12cm derdhur ne vend Shtrese betoni C 12/15 Shtrese me pllaka mermeri t=3cm Shtrese termoizoluese me polisterol t=10 cm Shtrese lluster cemento 1:2 t = 20 mm Hidroizolim me emulsion bitumi dhe 2 k katrama Lyerje betoni me astar me baze poliuretani Hidroizolim me emulsion bitumi dhe 1 k katrama Hidroizolim me emulsion dhe 2 bitum F.V. Dyer te brendeshme tamburate te rimesuara Dyer te blinduara F.V. Dyer te brendeshme metalike te blinduara. F.V. Dyer metalike llamarine	B (21-50 milionë lekë)

		<p>F.V. Dritare d/alumini plastike me dopio xham</p> <p>F.V. Dyer d/alumini plastike me dopio xham</p> <p>Boje hidroplastike</p> <p>Boje vaji sipërfaqe metalik etj</p>	
NS-9A	Punime strukturore speciale	<p>Shpim me sonda ne toka te zakonshme Ø800mm, thellesia (0-10m).</p>	<p>A</p> <p>(0- 20 milionë lekë)</p>
NS-14A	Impiante të brendshme elektrike, telefonike, radiotelefoni TV.	<p>Montim Box linje 20KV</p> <p>Montim Box transformatori 20 KV</p> <p>Montim Transformator me vaj 20-0.4 KV, 250KVA</p> <p>F.V. Kabell TM- XLPE180mmAL</p> <p>F.V.Koke kablli TM 20KV e brendshme</p> <p>F.V.Xhunto kablli TM 20KV e brendshme</p> <p>F.V.Zbara Cu ura box</p> <p>F.V.Kabell FG7(O)R 0,6/1KV, 1*95mm²</p> <p>F.V.Kabell FG7(O)R 0,6/1KV, 1*70mm²</p> <p>F.V.Kapikorta te dimensioneve te ndryshme</p> <p>F.V.Shirit tokezimi Zn 40x3mm</p> <p>F.V.Izolator mbeshtetes</p> <p>F.V.Tapet izolues 20KV, 95x65cm</p> <p>F.V Ventilator aksial 500m³h, 230V</p> <p>F.V.Termostat temperature</p> <p>Montim Kuader elektrik sipas skemes</p> <p>K.K.TU</p> <p>F.V.Strukture metalike mbrojtese</p> <p>F.V.Deviacion metalik B-Plan 90*, 150mm</p> <p>F.V.Deviacion metalik B-ndrim plan 150mm</p> <p>F.V. Xhunto bashkuese, buloneri dhe dado M10</p> <p>F.V Mbajtëse murale e lehtë 150mm</p> <p>F.V.Klips tub rigjit D32mm</p> <p>F.V.Klips tub rigjit D20mm</p> <p>FV.Tub plastik 100mm</p> <p>F.V Tub Kavidode D.63 mm</p> <p>FV.Tub kavidot 40mm</p> <p>F.V.Kabëll FG7(O)R 0,6/1KV, 5G50mm²</p> <p>F.V.Kabëll FG7(O)R 0,6/1KV, 5G35mm²</p> <p>F.V.Kabëll FG7(O)R 0,6/1KV, 5G16mm²</p> <p>F.V.Kabëll FG7(O)R 0,6/1KV, 3G6mm²</p> <p>Kabëll FG7(O)R 0,6/1KV, 3G2.5mm²</p> <p>F.V.Kabëll FG7(O)R 0,6/1KV, 3G1,5mm²</p>	<p>A</p> <p>(0- 20 milionë lekë)</p>

		<p> Montim Box PM1i kompletuar Montim Box PM2 i kompletuar Montim Box PM3 i kompletuar F.V. Kuadrot e ambienteve tregtare F.V.Ndricues hermetik 1x36w IP65 F.V.Llampa neon 36w F.V. Tub rigit D=20mm F.V.Kuti shpërndarëse C-4 Montim Aparaturë modulare TV FV.Tub flexibël seria e rëndë D=32mm FV.Tub flexibël seria e rëndë D=25mm FV.Tub flexibël seria e rëndë D=20mm FV.Kuti shpërdarëse PT-7 FV.Kuti shpërdarëse PT-6 FV.Kuti shpërdarëse PT-4 FV.RG56 Coaxial kable F.V.Kabëll telefonik J-H(ST)H, 4*0,6mm² FV. Çelës invertitor 10A FV. Çelës 2P 16A FV.Pulsant 1P 10A FV. Prizë shuko 16A FV.Tapa fallso FV.Prizë rjeti RJ11 F.V.Zile elektrike modulare Un=230V FV. Kuadër elektrik sipas skemës në projekt K.1+1 tip F.V. Kornetë vidiocitofonie FV. Shufër zingato D=10mm FV. Shtizë rufepritësi zingate 1.2m FV. Material montimi rufepritësi, vida, bulone, staffa, etj F.V.Puseta plastike 30x30x30cm F.V.Rilux 90LM 1H non-maintained 8W G5 F.V.Invertlux plus SA-SE 6-58W 230V (2,5-5h) Montim Ashensori FV.Kuti brenda muri 3mod Montim Aparaturë citofonie FV.Suport 3 module FV.Kapakë dekorativ 3 mod FV.Çelës deviator 1P 10A FV. Shkëputës togëzimi Kuader elektrik sipas skemës K.K.TU Box linje 20KV </p>	
--	--	---	--

		Box transformatori 20KV Transformator me vaj 20-0,4KV, 250KVA Box PM1 I kompletuar Box PM2 I kompletuar Box PM3 I kompletuar Aparaturë citofonie Aparaturë modularë TV etj.	
NS-18A	Punime Topogjeodezike	Punime matje volume dhe piketimi te themeleve, plintave kolonave dhe elementeve te tjere b/a etj.	A (0- 20 milionë lekë)

2.3.3 Operatori ekonomik duhet të përcaktojë me anë të një deklarate Drejtuesin Teknik të punimeve në objekt, i cili duhet të jetë i përfshirë në licencën e shoqërisë, dhe të deklarojë se nuk është i angazhuar në kontrata të tjera dhe do të jetë i pranishëm gjatë gjithë kohës që do të kryhen punimet në objekt, të figurojë në listpagesat e shoqërisë minimumi per **3 (tre)** muajt e fundit të deklaruar nga data e hapjes se ofertave shoqëruar me dokumentacionin e mëposhtme:

- a) Kontratë pune e vlefshme;
- b) Diplomë.
- c) C.V (përkatëse)

Shënim: Dokumentacioni provues do të paraqitet nga ofertuesi i kualifikuar në vend të parë, pranë autoritetit kontraktor, përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, ose nëse do të jetë nevoja për tu kërkuar sqarime nga AK.

Argumentimi: Kjo kërkesë mbështetet ne nenin 77, pika 4 te Ligjit Nr. 162, datë 23.12.2020 “Për Prokurimin Publik” (i ndryshuar), si dhe në nenin 39, pika 6, gërma “c” te VKM-se Nr. 285 datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” (i ndryshuar).

Duke qenë se objekt prokurimi është kontratë pune, sqarojmë se detyrimin për prezencën e Drejtuesit Teknik gjatë gjithë kohës që do të kryhen punimet në objekt e përcakton qartazi Udhëzimi Nr. 2, datë 13.05.2005 “Për zbatimin e punimeve të ndërtimit”, konkretisht pika 1.2 ku citohet se: “drejtuesit ligjore dhe teknik te sipërmarrësit janë përgjegjës përpara investitorit për ndërtimin e veprës, sipas projektit, për kryerjen e punimeve të ndërtimit, në përputhje me kushtet teknike të zbatimit, specifikimet teknike, sigurimin teknik dhe mbrojtjen në punë, brenda kushteve të kontratës e dispozitave ligjore në fuqi” si dhe pikës 2.1 ku citohet se “drejtimi teknik i punimeve në kantier sigurohet, sipas rastit, drejtpërdrejtë nga drejtuesi teknik i sipërmarrësit ose përgjegjësi teknik i kantierit. Lidhur me kërkesën që Drejtuesi Teknik i punimeve në objekt duhet të jetë i përfshirë në licencën e shoqërisë dhe të mos jetë i angazhuar në kontrata të tjera, mbështetet në Vendimin e Këshillit të Ministrave Nr. 42, datë 16.1.2008 “Për miratimin e rregullores për kriteret dhe procedurat e dhënies së licencave profesionale të zbatimit, klasifikimit dhe disiplinimit të subjekteve juridike, që ushtrojnë veprimtari ndërtimi”, pika 2 ku përcaktohet se: “Papajtueshmëritë me detyrën e drejtuesit teknik të shoqërisë së zbatimit Drejtuesit teknik të shoqërisë nuk mund të jenë personat që janë të angazhuar në çdo punë-marrje tjetër publike. Drejtuesi teknik i shoqërisë nuk mund të jetë njëkohësisht i punësuar në dy apo më shumë shoqëri ndërtimi dhe ndalohet të disponojnë licencë për mbikëqyrje e kolaudim të punimeve të zbatimit” dhe pika 2: “elementët e licensës” gërma “c” ku citohet se: “Licencat e shoqërive jepen me afat të njëjtë me atë për të cilin janë regjistruar për të ushtruar veprimtari në QKR apo gjykatë. Ndalohet ushtrimi i veprimtarisë zbatuese në ndërtim në mungesë të drejtuesit/ve teknikë të shoqërisë. Shoqëritë e licencuara jo më vonë se 10 ditë kalendarike, kur drejtuesi teknik është dorëhequr ose ka

pamundësi fizike për ushtrimin e detyrës (aksident, sëmundje me paaftësi ushtrimi detyre mbi 14 ditë, invaliditet, ndarje nga jeta), kanë detyrimin të paraqesin njoftim së bashku me kërkesën për drejtuesin e ri teknik të shoqërisë”.

Për sa më lart, çdo kërkesë e renditur për Drejtuesin Teknik, buron nga kontrata e punës objekt prokurimi, me qëllim përmbushjen dhe realizimin e saj sipas kushteve dhe dipsozitive ligjore në fuqi.

2.3.4 Një punësim minimalisht prej **65 (gjashtëdhjetë e pesë) punonjës**, të cilët duhet të figurojnë në listpagesat e shoqërisë minimumi për 3 muajt e fundit të deklaruar nga data e hapjes së ofertave vërtetuar me:

- a. Vërtetim të lëshuar nga Administrata Tatimore për **3 muajt** e fundit të deklaruar nga data e hapjes së ofertave.
- b. Listpagesat e punonjesve të konfirmuara nga autoritetet perkatese sipas formatit që kërkohej nga legjislacioni në fuqi për **3 muajt** e fundit të deklaruar.

Argumentimi: Në bazë të pikës 4, të nenit të 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” i ndryshuar dhe nenit 39, pika 6/ç dhe 6/d, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, me anë të këtij kriteri kërkohej që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë fuqinë minimale punëtoresh, të nevojshme për ekzekutimin e objektit të prokurimit, të nevojshme për ekzekutimin e objektit të prokurimit, që ka në dispozicion apo që mund t’i vihen në dispozicion operatorit ekonomik për të përmbushur kontratën.

Në përcaktimin e numrit të punonjësve specialisti i fushës ka bërë një analizë bazuar tek faktorët, si volumet dhe kategoritë e punimeve, kualifikimi i punonjësve, grafiku i punimeve, zërat e punimeve dhe orët e punës dhe pagën minimale të lejuar që duhen për të përmbushur kontratën. Numri i punonjësve dhe qëndrueshmëria e tyre në punë me kohështirje tre mujore nga data e zhvillimit të tenderit, tregon besueshmëri për autoritetin që, operatori do të përmbushë kontratën. Dëshmia e kërkuar për numrin e fuqisë punëtoresh të operatorit ekonomik e nevojshme për ekzekutimin e objektit të kontratës, është dokument që vërteton kapacitetin teknik dhe profesional të operatorit, për sa kohë janë në përpjesëtim me natyrën dhe përmasat e kontratës. Deklarimi dhe regjistrimi i punonjësve në regjistrin e sigurimeve është një detyrim ligjor i punëdhënësit e parashikuar nga Kodi i Punës, për rrjedhojë vërtetimi i lëshuar nga administrata tatimore e shoqëruara me listpagesat me këtë kohështirje është dokument vërtetues për qëndrueshmërinë e të punësuarve, përvojën e tyre, dhe janë në përpjesëtim me natyrën dhe përmasat e kontratës. Punësimi i një numri të caktuar, përveç besueshmërisë së operatorëve ekonomik, si një nga kërkesat themelore të kualifikimit, përpiket të kufizojë edhe problematikat sociale dhe shmangien e informalitetit në tregun e punës. Po ashtu është një tregues i kualifikimit dhe eksperiencës që duhet të ketë kjo kategori e punonjësve. Vendosja e kriterit për një punësim të paktën 65 punonjës duke përfshirë dhe stafin teknik, është në përputhje me volumin e punës, natyrën e punimeve. Kriteri për kualifikim është vendosur që t’i shërbejë autoritetit për të njohur gjendjen e kapaciteteve të operatorëve të cilët nëpërmjet dokumentacionit të vërtetojnë se zotërojnë, kapacitetet teknike dhe profesionale, personelin e nevojshëm, si dhe kapacitetet organizative, gjithçka në funksion të realizimit me sukses të kontratës.

Analizat teknike janë bazuar në VKM Nr. 216, datë 13.04.2023 “Për miratimin e manualeve teknike të çmimeve të punimeve të ndërtimit dhe të analizave teknike të tyre”. Bazuar në këto elementet e strukturës së kostos (material, puntori, makineri, transport).

(Numri i punonjësve, i mjeteve/makinerive që nevojiten për realizimin e kontratës është përcaktuar bazuar në ligjin Nr. 8402 datë 10.09.1998 “Për kontrollin dhe disiplinimin e punimeve të ndërtimit”, i ndryshuar dhe akteve nenligjore)

Në mënyrë të përmbledhur numri i fuqisë puntorë që kërkohej për realizimin e punimeve është min 65 punonjës.

2.3.5 Operatorët ekonomik pjesëmarrës duhet të kenë të punësuar staf inxhinierik për kryerjen e të gjitha punimeve në objekt, të perfshire në licencën e shoqërisë, të vërtetuar me kontratë pune të vlefshme, CV, diplomë përkatëse si dhe të figurojnë në listpagesat e shoqërisë për **3 muajt** e fundit të deklaruar nga data e hapjes së ofertave, konkretisht:

- **1 (një) Arkitekt**
- **1 (një) Inxhinier Ndertimi Profili Strukturist**
- **1 (një) Inxhinier Ndertimi Profili Gjeoteknike**
- **1 (një) Inxhinier Hidroteknik**
- **1 (një) Inxhinier Elektrik**
- **1 (një) Inxhinier Mjedisi**
- **1 (një) Inxhinier Gjeolog**
- **1 (një) Inxhinier Topograf/Gjeodet/Markshejder**

***Shënim:** Kjo kërkesë përmbushet nëpërmjet plotësimit dhe paraqitjes nga operatorët ekonomikë të formularit përmbledhës të vetëdeklarimit, sipas shtojcës 8 të DST.*

Dokumentacioni provues do të paraqitet nga ofertuesi i kualifikuar në vend të parë, pranë autoritetit kontraktor, përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, ose nëse do të jetë nevoja për tu kërkuar sqarime nga AK.

***Argumentimi:** AK argumenton se kjo kërkesë mbështetet në nenin 77, pika 4 të Ligjit Nr. 162, datë 23.12.2020 “Për Prokurimin Publik” (i ndryshuar), si dhe në nenin 39, pika 6, gërma “c” të VKM-se Nr. 285 datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” (i ndryshuar).*

Kriteri për stafin drejtues teknik, lidhet ngushtësisht me objektin e kontratës, relacionin teknik dhe zërat e punimeve. Nevoja për inxhinierët në objekt është e diktuar nga përvoja dhe legjislacioni për punimet e ndërtimit. Mungesa e këtij stafi pothuajse në çdo rast rezultojnë në realizim jashtë afatit, jashtë normave dhe me cilësi të dobët të objekteve. Numri i stafit kryesor teknik si numri i inxhinierëve të ndërtimit, etj është përcaktuar nga pikëpamja e natyrës teknike të kontratës me qëllimin për të patur një rezultat sa më të mirë në mbarëvajtjen dhe zbatimin e punimeve. Operatorët ekonomikë duhet të vërtetojnë se zotërojnë kualifikimet e nevojshme teknike, profesionale, kapacitetet organizative, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm, për të zbatuar kontratën. Drejtues teknik është përgjegjës për ndërtimin në përputhje me kushtet teknike të zbatimit, sigurimin teknik dhe mbrojtjen në punë brenda kushteve të kontratës. Bazuar në parashikimet e mësipërme të legjislacionit për prokurimin publik, Autoriteti Kontraktor ka kërkuar që operatori ekonomik ofertues duhet të ketë në stafin e tij **drejtues teknik** të cilët kanë një rol të rëndësishëm në mbarëvajtjen e punimeve pasi ata janë përgjegjës për zbatimin e objektit sipas projektit dhe në përputhje me kushtet teknike të zbatimit të tij.

Kërkesa specifike për Inxhinierët e kërkuar është përcaktuar në kuadër të analizës teknike që i është bërë Preventivit të Punimeve (nga ku përcaktohet qartazi dhe profili inxhinierik) si dhe në bashkrendim me kategoritë e kërkuara në Licencën profesionale të shoqërisë sipas pikës 2.3.2, kapaciteti teknik në DST. Duke marrë në konsideratë Projektin e zbatimit si dhe Preventivin e Punimeve rezultojnë se është e domosdoshme që çdo Ofertues të ketë pjesë të stafit Inxhinierë të kërkuar si me sipër, të cilët në bashkëpunim me njëri tjetrin si dhe me fuqinë punëtore të shoqërisë do të realizojnë me sukses kontratën objekt prokurimi.

Lidhur me kërkesën që Drejtuesit Teknik të punimeve në objekt duhet të jenë të përfshirë në licencën e shoqërisë mbështetet në Vendimin e Këshillit të Ministrave Nr. 42, datë 16.1.2008 “Për miratimin e rregullores për kriteret dhe procedurat e dhënies së licencave profesionale të zbatimit, klasifikimit dhe disiplinimit të subjekteve juridike, që ushtrojnë veprimtari ndërtimi”, pika 2 ku përcaktohet se: “Papajtueshmëritë me detyrën e drejtuesit teknik të shoqërisë së zbatimit Drejtuesit teknikë të shoqërisë nuk mund të jenë personat që janë të angazhuar në çdo punë-marrje tjetër publike. Drejtuesi teknik i shoqërisë nuk mund të jetë njëkohësisht i punësuar në dy apo më shumë

shoqëri ndërtimi dhe ndalohet të disponojnë licencë për mbikëqyrje e kolaudim të punimeve të zbatimit” dhe pika 2: “elementët e licensës” gërma “c” ku citohet se: “Licencat e shoqërive jepen me afat të njëjtë me atë për të cilin janë regjistruar për të ushtruar veprimtari në QKB apo gjykatë. Ndalohet ushtrimi i veprimtarisë zbatuese në ndërtim në mungesë të drejtuesit/ve teknikë të shoqërisë. Shoqëritë e licencuara jo më vonë se 10 ditë kalendarike, kur drejtuesi teknik është dorëhequr ose ka pamundësi fizike për ushtrimin e detyrës (aksident, sëmundje me paaftësi ushtrimi detyre mbi 14 ditë, invaliditet, ndarje nga jeta), kanë detyrimin të paraqesin njoftim së bashku me kërkesën për drejtuesin e ri teknik të shoqërisë”.

Duke marrë në konsideratë Projektin e zbatimit si dhe Preventivin e Punimeve rezulton se është e domosdoshme që çdo Ofertues të ketë pjesë të stafit Inxhinierë të kërkuar, të cilët në bashkëpunim me njëri tjetrin, stafin mbeshtetes si dhe me fuqinë punëtore të shoqërisë do të realizojnë me sukses kontratën objekt prokurimi.

- **Arkitekt** është përgjegjës për zbatimin e saktë të punimeve arkitekturore sipas projektit arkitektonik.
- **Inxhinier Ndërtimi profili Strukturist** është përgjegjës për zbatimin e saktë të punimeve objekt kontrate për të gjithë zërat e punimeve ndërtimore dhe konstruksionit, sipas parashikimeve në projektin konstruktiv.
- **Inxhinier Ndërtimi profili Gjeoteknike** është përgjegjës për zbatimin e saktë të punimeve objekt kontrate për të gjithë zërat e punimeve themelesh pilotat , sipas parashikimeve në projektin konstruktiv.
- **Inxhinieri Hidroteknik** është përgjegjës për zbatimin e saktë të punimeve hidroteknike lidhur me zërat e punimeve të parashikuara në projekt-preventiv.
- **Inxhinieri Elektrik** është përgjegjës për zbatimin e saktë të punimeve elektrike lidhur me zërat e punimeve të parashikuara në projekt-preventiv.
- **Inxhinier Mjedisi** është përgjegjës për zbatimin e saktë të punimeve në lidhje me mjedisin te objektit lidhur me zërat e punimeve të parashikuara në projekt-preventiv.
- **Inxhinier Gjeolog** është përgjegjës për vleresimin e kushteve gjeologjike të zonës ku do të ndërtohet objekti.
- **Inxhinier Topograf/ Gjeodet/Markshajder** është përgjegjës për zbatimin e saktë të punimeve qe perfshin kuota dhe piktetime lidhur me zërat e punimeve të parashikuara në projekt-preventiv.

2.3.6 Operatori ekonomik për realizimin e punimeve objekt kontrate, duhet të disponojë edhe staf (jo domosdoshmërisht drejtues teknik në licencën e shoqërisë), si më poshtë:

- **1 (një) person, i certifikuar si Specialist Për Testimin e Performances se Materialeve/Produkteve te Ndërtimit /Inxhinier Materialelesh.**

*** *Kriteri konsiderohet i përmbushur me vetëdeklarimin sipas Formularit Përmbledhës të Vetëdeklarimit, sipas Shtojcës perkatese te DST, “Përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së*

afateve të ankimit, autoriteti/enti kontraktor i kërkon ofertuesit të kualifikuar i pari dorëzimin e dokumenteve provuese”.

Për secilin pjesëtar të stafit të mësipërm duhet të paraqesë: Kontratë pune e vlefshme, Diplomë, Librezë pune dhe C.V si edhe të figurojë në listëpagesat e shoqërisë për 3 muajt e fundit.

Shënim: Dokumentacioni provues do të paraqitet nga ofertuesi i kualifikuar në vend të parë, pranë autoritetit kontraktor, përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, ose nëse do të jetë nevoja për tu kërkuar sqarime nga AK.

Argumentimi: AK argumenton se kërkesa për stafin inxhinierik është vendosur sipas përcaktimeve të Ligjit Nr. 162, datë 23.12.2020 “Për Prokurimin Publik” i ndryshuar, Neni 77, pika 4, si dhe në VKM Nr. 285 datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar Kreu V, Seksioni III, Neni 39, pika 6, germa “c”.

Kriteri për stafin e mësipërm, lidhet ngushtësisht me objektin e kontratës, relacionin teknik dhe zërat e punimeve. Nevoja për inxhinierët në objekt është e diktuar nga përvoja dhe legjislacioni për punimet e ndërtimit. Mungesa e këtij stafi pothuajse në çdo rast rezulton në realizim jashtë afatit, jashtë normave dhe me cilësi të dobët të objekteve. Numri i stafit kryesor teknik si numri i inxhinierëve të ndërtim, hidroteknik, etj është përcaktuar nga pikëpamja e natyrës teknike të kontratës me qëllimin për të patur një rezultat sa më të mirë në mbarëvajtjen dhe zbatimin e punimeve. Operatorët ekonomikë duhet të vërtetojnë se zotërojnë kualifikimet e nevojshme teknike, profesionale, kapacitetet organizative, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm, për të zbatuar kontratën

Kërkesa specifike për Inxhinierët e kërkuar jo domosdoshmërisht të përfshirë në licencën e shoqërisë është përcaktuar në kuadër të analizës teknike që i është bërë Preventivit të Punimeve (nga ku përcaktohet qartazi dhe profili inxhinierik) si dhe në bashkrendim me kategoritë e kërkuara në Licencën profesionale të shoqërisë sipas pikës 2, kapaciteti teknik në DST. Duke marrë në konsideratë Projektin e zbatimit si dhe Preventivin e Punimeve rezulton se është e domosdoshme që çdo Ofertues të ketë pjesë të stafit Inxhinierë të kërkuar si me siper, të cilët në bashkëpunim me njëri tjetrin si dhe me fuqinë punëtore të shoqërisë do të realizojnë me sukses kontratën objekt prokurimi.

Kriteri konsiderohet i përmbushur me vetëdeklarimin sipas Formularit Përmbledhës të Vetëdeklarimit, sipas shtojcës nr. 8. Formulari i vetëdeklarimit duhet të përmbajë kërkesat e autoritetit. Autoriteti/enti kontraktor, përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, i kërkon ofertuesit të kualifikuar i pari, dorëzimin e dokumenteve provuese.

- **Specialist Për Testimin e Performances së Materialeve/Produkteve të Ndërtimit /Inxhinier Materiale** është përgjegjës për vlerësimin dhe testimin e materialeve dhe produkteve që përdoren në industrinë e ndërtimit për t’u siguruar që ato përmbushin standardet e kërkuara për sigurinë dhe cilësinë. Ky lloj specialisti duhet të ketë njohuri të thella në lidhje me metodat e testimit, standardet kombëtare dhe ndërkombëtare, dhe materialet që përdoren në ndërtim.

2.3.7 Operatori ekonomik duhet të ketë të punësuar staf teknik për kryerjen e punimeve, të vërtetuar me kontratë punë të vlefshme, një dokument që të vërtetojë kualifikimin profesional (dëshmi kualifikimi profesional/certifikatë/diplomë), lëshuar nga institucione (shtetërore apo private) të licencuara/akredituara nga autoritetet përgjegjëse shtetërore, sipas ligjit nr. 15/2017 “Për arsimin dhe formimin profesional në Republika e Shqipërisë” si dhe të figurojnë në listëpagesat e shoqërisë për 3 muajt e fundit të deklaruar nga data e hapjes së ofertave, si më poshtë:

STAF TEKNIK	NUMRI
Teknik Ndërtimi	1
Hidraulik	2
Elektracist	3
Hekurkthyes	3
Karpentier	4
Betonues	3
Punonjes I izolimeve (Hidroizolues)	3
Murator	3
Suvatues	3
Pllakashtrues	3
Punonjes per dyer dritare	2
Bojaxhi	3
Specialist veshje fasade	4
Eskavatorist	2
Shofer	2
Automakinista	1

2.3.7/I Për punonjesit eskavatorist/ automakinist/shofer, ofertuesi duhet të paraqesë:

- a) kontratë individuale të punës;
- b) leje drejtimi, certifikate e aftesimit profesional (CAP) për shoferet dhe dëshmi aftesimi profesional (DAP) për manovratorët-automakinistët/eskavatoristët, që të vërtetojë kualifikimin profesional të kërkuar, referuar rregullores “Për kushtet, kriteret dhe programet për përgatitjen teoriko-praktike të kandidatëve, si dhe dhënien e Dëshmisë së Aftësisë Profesionale për përdoruesit e makinerive të rënda për punime ndërtim dhe toke, si dhe disiplinimi i përdorimit të tyre”, miratuar me urdhërin nr. 200, datë 16.5.2019, të Ministrisë të Infrastrukturës dhe Energjitikës.

(Në rastin kur punonjësit Manovrator/shofere janë të kontraktuar me kontratë pune (respektivisht për mjetet e marra me qera), nuk kërkohet të figurojnë në listpagesat e shoqërisë).

Shënim: Kjo kërkesë përmbushet nëpërmjet plotësimit dhe paraqitjes nga operatorët ekonomikë të formularit përmbledhës të vetëdeklarimit, sipas shtojcës 8 të DST.

Dokumentacioni provues do të paraqitet nga ofertuesi i kualifikuar në vend të parë, pranë autoritetit kontraktor, përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, ose nëse do të jetë nevoja për tu kërkuar sqarime nga AK.

Argumentimi: Kjo kërkesë mbështetet në Ligjin Nr. 162, datë 23.12.2020 “Për Prokurimin Publik”, Neni 77, pika 4, si dhe në VKM Nr. 285 datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” I ndryshuar, Kreu V, Seksioni III, Neni 39, pika 6, gërma “ç”. Qëllimi i vendosjes së këtij kushti është i implementuar sipas dispozitave ligjore dhe shërben si një garanci që kontrata objekt prokurimi do të realizohet me sukses sipas Specifikimeve Teknike (të cilat do publikohen së bashku me Dokumentat e Tenderit) si dhe punimet do të kryhen brenda afatit kohor të parashikuar në Njoftimin e Kontratës. Sqarojmë se, të gjithë specialistët e kërkuar janë në përputhje të plotë me projekt-preventivin duke marrë në konsideratë volumet e punes që do të realizohen, si dhe kohëzgjatjen e tyre. Autoriteti Kontraktor domosdoshmërisht duhet të garantohet që këto punime do të kryhen

nga persona të kualifikuar dhe me eksperiencë të mjaftueshme, për zbatimin e këtyre punimeve sipas standarteve të percaktuara në specifikimet teknike. Zbatimi i punimeve që përfshin projektin duhet të kryhet nga fuqi punëtore e kualifikuar për secilën tipologji punimesh. Për të vërtetuar kualifikimin e stafit teknik është kërkuar që të jenë të pajisur me dokument që të vërtetojë kualifikimin profesional (dëshmi kualifikimi profesional/certifikatë/diplomë), lëshuar nga institucione (shtetërore apo private) të licencuara/akredituara nga autoritetet përgjegjëse shtetërore, sipas ligjit nr. 15/2017 “Për arsimin dhe formimin profesional në R.Sh.”. Mbështetur në këtë legjislacion certifikimet profesionale ofrohen nga institucione të licensuara nga Ministria përkatëse nëpërmjet Agjencise Kombëtare të Arsimit, Formimit Profesional. Certifikatat e këtyre specialisteve duhet të jenë të të regjistruara në “rregjistrat profesionale” të AKAFP-se. Percaktimi i numrit të punonjesve dhe profesionet është bazuar mbi zërat dhe volumet e punës si dhe afateve për perfundimin e punimeve, në mbështetje të jave bazuar në VKM nr. 216, datë 13.4.2023 “Për krijimin dhe funksionimin e sistemit të integruar përinformatizimin e manualit të çmimeve për zërat e punimeve në ndërtim”. Bazuar në kater elementet e strukturës së kostos (material, puntori, makineri, transport). Numri i punonjesve, dhe profesionet që nevojiten për realizimin e kontratës është përcaktuar bazuar në ligjin Nr. 8402 date 10.09.1998 “Për kontrollin dhe disiplinimin e punimeve të ndërtimit”, i ndryshuar dhe akteve nenligjore.

Personeli i mësipërm kërkohej në bazë të vlerësimit të preventivit dhe të grafikut të punimeve.

2.3.8 Operatorët ekonomik pjesëmarrës duhet të kete pjesë të stafit të tij ose si staf mbështetës (me kontrate pune/kontratë bashkëpunimi) si më poshtë:

- a) 1 (një) punonjës me çertifikatë "Përgjegjës për sigurinë dhe mbrojtjen e shëndetit në punë" në përputhje me klauzolat e Ligjit Nr. 10327 datë 18/02/2010 "Për sigurinë dhe shëndetin në punë" dhe V.K.M Nr. 312, date 05.05.2010 "Për miratimin e rregullores "Për sigurinë në kantier".
- b) 2 (dy) punonjës të pajisur me çertifikatë : “Specialist për punimet në lartësi” sipas V.K.M Nr.312, date 05.05.2010 "Për miratimin e rregullores "Për sigurinë në kantier", të cilat të jenë të lëshuara nga shoqëri të licencuara/akredituara ose nga organizma ndërkombëtare të njohur nga Republika e Shqipërisë.

Për punonjësit e mësipërm Operatori Ekonomik duhet të paraqesë:

- Kontratat individuale të punës (të vlefshme).
- Diplomë/Certifikatë

Shënim: Kjo kërkesë përmbushet nëpërmjet plotësimit dhe paraqitjes nga operatorët ekonomikë të formularit përmbledhës të vetëdeklarimit, sipas shtojcës 8 të DST.

Dokumentacioni provues do të paraqitet nga ofertuesi i kualifikuar në vend të parë, pranë autoritetit kontraktor, përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, ose nëse do të jetë nevoja për tu kërkuar sqarime nga AK.

Argumentimi : Në bazë të pikës 4, të nenit të 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 39, pika 6/c), të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” dhe V.K.M nr. 312, datë 05.05.2010 “Për miratimin e rregullores “Për sigurinë në kantier” me anë të këtij kriteri kërkohej që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë personelin e nevojshëm të kualifikuar për realizimin me sukses të kontratës.

Kërkesa e mësipërme mbështet në ligjin Nr. 10237 datë 18/02/2010 “Për sigurinë dhe shëndetin në punë”. Natyra e kontratës dhe specifikat e saj kërkojnë njohuri e përgatitje të posaçme për vlerësime të përpikta për të zgjidhur çështje që lidhen me garantimin e sigurisë dhe mbrojtjen në punë. Në rregulloren për sigurinë në kantier miratuar me VKM Nr. 312/2010 është përcaktuar se punëdhënësi për mbrojtjen dhe parandalimin nga rreziqet, duhet të ndjekë kurse formimi përkatës në fushën e sigurisë e të shëndetit në vendin e punës. Çdo punëdhënësi zgjedh një

ose disa persona si përgjegjës për ndihmën e parë në rast emergjencash dhe për sigurinë e mbrojtjen e shëndetit. Rregullorja përcakton kërkesat minimale të sigurisë dhe të shëndetit në punë për kantieret e përkohshëm ose të lëvizshëm, si dhe masat e përgjithshme të mbikëqyrjes

-“Përgjegjës për sigurinë dhe mbrojtjen e shëndetit në punë” rekomandohet të jete në kantier për trajnimin e punonjesve te kantierit për minimizimin e aksidenteve në punë.

-Punonjësit e pajisur me certifikaten e Trajnimit për “Punime në lartësi” është sipas V.K.M Nr. 312, date 05.05.2010 "Për miratimin e rregullores "Për sigurinë në kantier" në projekt-preventiv ka punime skelerie në lartësi, të cilën e bëjnë të nevojshme kërkesa për punonjës të certifikuar dhe trajnuar për punime në lartësi.

2.3.9 Deklaratë e ofruesit për modelin, kompaninë prodhuese, për mallrat e pajisjet që do të vendosen në objekt sipas tabelës së mëposhtme:

Nr.	Emërtimi i pajisjes/materialeve	Modeli	Kompania prodhuese, Web, E-mail, Nr. kontakti
1	F. Grup Presioni i Ujit të Pijshëm, komandim inverter i shpejtësisë: Q = 6,5 m ³ /h; P (H) = 4.0 bar (≈ 40 m)		
2	Elektropompë zhytëse, Q=200l/min, H=4m		
3	F. Grup Presioni i Sistemit Kundrazjarrit (Pompë Elektrike + Pompë me motor Diezel + pompë pilot - jockey pump) Q = 20 m ³ /h; P (H) = 5.0 bar (50 m), Q pilot = 4 m ³ /h; P (H) = 5.5 bar (55 m)		
4	Transformator me vaj 20-0,4KV, 250KVA		

2.3.9/a Për pajisjet/materialet e tabelës së dhënë në pikën 2.3.9, Operatori ekonomik duhet të paraqesë autorizim nga prodhuesi ose distributori i autorizuar, me të cilin prodhuesi ose distributori i autorizuar, autorizon kompaninë pjesëmarrëse në tender të ofertojë këto pajisje/materiale. Në rast paraqitje autorizim distributori autorizuar, duhet të paraqitet kontrata ose dokumenti i angazhimit midis prodhuesit dhe distributorit, për materialet kryesore të kerkuara.

2.3.9/b Të paraqiten katalogët nga prodhuesi/prodhuesit apo distributorit të autorizuar nga prodhuesi, për të gjitha pajisjet/materialet sipas pikës 2.3.9. Në katalogë, duhet të markohet me ngjyrë të qartë pajisja/materiali që ofrohet dhe të pasqyrohen specifikimet teknike të kërkuara për këto pajisje/materiale.

2.3.9/c OE të paraqesë një deklaratë, ku merr përsipër të garantojë instalimin si dhe servisin e pajisjeve gjatë periudhës së garancisë (2 vite), për defektet që vijnë nga prodhimi i tyre.

Fleta ose fletët e katalogut që pasqyrojnë specifikimet teknike të kërkuara të pajisjeve/materialeve, duhet të paraqiten në gjuhën shqipe, të përkthyer dhe noterizuar.

Argumentimi : Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar, nenin 39, pika 8, si dhe ,në bazë të nenit 45, pika 1 të VKM–së Nr. 285 datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, i ndryshuar.

Në preventivin e punimeve ka furnizim vendosje pajisje dhe nisur nga pesha specifike si në sasi dhe në vlerë që këto zëra zënë në preventiv. AK e ka parë të domosdoshme kërkimin e autorizimit të prodhuesit për të garantuar cilësinë e pajisjeve për nga vetë rendesia që ka ky objekt. Kërkesa e këtij dokumenti që ne kete faze krijon nje lehtësi per Autoritetin Kontraktor pasi ne kete menyre siguron cilesine, specifikimet teknike te ketyre pajisjeve e cila eshte lehtesisht e kontrollueshme gjate fazes se zbatimit ne reference me dokumentat e paraqitura qe gjate kualifikimit. Nepermjet dorezimit te këtij dokumentacioni qe ne fazen e vleresimit asnje OE ekonomik nuk i shmanget dot detyrimit qe gjate zbatimit te furnizojte te njejtin mall te certifikuar nga KVO.

Kjo kërkesë është kërkuar që t’i sigurojë Autoritetit Kontraktor që operatori ekonomik ka kapacitetin e nevojshem teknik dhe ploteson specifikimet e kerkuara nga projektuesit për zbatimin në kohë dhe cilësi të kontratës për këtë objekt. Për të krijuar bindjen e autoritetit kontraktor për aftësitë teknike, aftësitë organizative, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur të operatorëve ekonomik fitues potencialë dhe realizimin me sukses të kontratave, njësia e prokurimit vlerëson se operatorët ekonomikë duhet të paraqesin autorizim nga prodhuesi/distributori, me të cilin prodhuesi/ distributor autorizon kompaninë pjesëmarrëse në tender të ofertojë pajisjet dhe mallrat e nevojshme në këtë procedurë prokurimi. Duke qenë se materialet e kerkuara prodhohen në mënyrë industriale, certifikimi nga prodhuesi mbi parametrat e tyre është i domosdoshëm.

Duke marrë shkas nga tipologjia e objektit të prokurimit dhe nga punimet/sherbimet që parashikohen të realizohen në preventive si dhe per shkak te interesit te larte qe ka objekti duhet të garantohet që mallrat kryesore të jenë sipas standarteve më të mira europiane, eshte gjykuar të domosdoshme të garantohet që mallrat kryesore të jenë sipas standarteve më të mira europiane, që OE ka aftësi të mjaftueshme për të realizuar me sukses dhe cilësi kontratën, duke furnizuar brenda kohës së përcaktuar vetëm pajisje origjinale me garanci, si dhe i shërben Autoritetit Kontraktor për të bërë krahasueshmërinë e materialeve të ofruara nga operatori me ato të kërkuara në dokumentat e tenderit. Për të siguruar këtë gjë, por njëkohesisht dhe për të detyruar ofertuesit e mundshëm në zbatimin e këtyre standarteve ka parashikuar kërkesen e mësipërme, vetëm për disa nga mallrat kryesorë me që do të përdoren në këtë objekt dhe konkretisht OE duhet të japin dhe paraqesin ne menyre te detajuar karakteristikat teknike të mallrave të përfshirë në dokumentat e tenderit, karakteristika këto që duhet të përputhen me specifikimet teknike të kërkuara nga projektuesi. Me anë të venies ne dispozicion ne fazen e ofertimit dokumentat si autorizim-marreveshje angazhimi, kataloge, ofertuesi garanton Autoritetin Kontraktor se mallrat që do të furnizojë do të jenë prodhim sipas kerkesave te projektit. Plotesimi i kerkeses me siper garanton Autoritetin Kontraktor për cilësinë dhe standartet e larta ndërkombëtare dhe të përditësuara sipas teknologjisë së re dhe bashkëkohore.

2.3.10 Operatori ekonomik duhet të paraqesë certifikatat si më poshtë:

- a) Certifikatën e cilësisë së punimeve SSH/DIN/EN/UNI **ISO 9001-2015** e përditësuar, e vlefshme/ose/ekuivalent. Certifikata të jetë leshuar nga një organ i vlerësimit të konformitetit, i akredituar nga organizmi kombëtar i akreditimit ose organizma ndërkombëtarë akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë.
- b) Certifikatën për Sistemin e menaxhimit të mjedisit SSH/DIN/EN/UNI **ISO 14001-2015** e përditësuar, e vlefshme /ose/ ekuivalent. Certifikata te jetë leshuar nga një organ i vlerësimit të konformitetit, i akredituar nga organizmi kombëtar i akreditimit ose organizma ndërkombëtarë akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë.
- c) Certifikatën SSH/DIN/EN/UNI **ISO 45001:2018** e përditësuar, (SSH/DIN/EN/UNI **ISO 45001 – 2023**) e vlefshme/ ose ekuivalent (Mbi Sistemet e menaxhimit të shendetit dhe sigurisë të punëtorëve në punë ose ekuivalent). Certifikata te jetë leshuar nga një organ i vlerësimit të konformitetit, i akredituar nga

organizmi kombëtar i akreditimit ose organizma ndërkombëtarë akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë.

- d) Certifikatën SSH/DIN/EN/UNI **ISO 50001-2018**, e përditësuar, e vlefshme/ ose ekuivalent (Sistemi i Menaxhimit të Energjisë e vlefshme ose ekuivalent). Certifikata të jetë lëshuar nga një organ i vlerësimit të konformitetit, i akredituar nga organizmi kombëtar i akreditimit ose organizma ndërkombëtarë akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë.

Në rastet e Bashkimit të Operatorëve ekonomik, Operatori ekonomik do të paraqesë ISO-t në baze të zerave të punimeve që ka marrë persiper të realizoje.

Pranohet dhe paraqitja e standardeve shqiptare **SSH/DIN/EN/UNI** mbi konformitetin e standardeve europiane dhe të lëshuara nga organizma të vlerësimit të konformitetit të akredituara në Republikën e Shqipërisë.

Argumentim: Kërkesat e cilësisë të përcaktuara sipas pikës 2.3.10 gërma “a”- e” janë vendosur në mbështetje të Ligjit Nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik” (i ndryshuar), Neni 79, pika 1 ku citohet se: *“Autoriteti ose enti kontraktor për të vërtetuar se punët, mallrat ose shërbimet, objekt prokurimi, i plotësojnë kërkesat e cilësisë, mund t’u kërkojë ofertuesve të paraqesin certifikata të lëshuara nga një organ i vlerësimit të konformitetit, i akredituar nga organizmi kombëtar i akreditimit ose organizma ndërkombëtarë akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë”*, si dhe në zbatim të Neni 44, pika 1 dhe pika 3 të VKM Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, ku përcaktohet se: *“Autoriteti/enti kontraktor, për të vërtetuar se punët, mallrat ose shërbimet, objekt prokurimi, i plotësojnë kërkesat e cilësisë, mund t’u kërkojë ofertuesve të paraqesin certifikata të lëshuara nga një organ i vlerësimit të konformitetit, i akredituar nga organizmi kombëtar i akreditimit ose organizma ndërkombëtarë akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë, vetëm nëse ato janë të argumentuara dhe të lidhura ngushtësisht dhe në mënyrë të drejtpërdrejtë me objektin e prokurimit”*.

ISO 9001:2015 / ekuivalente është një seri normash dhe standartizimesh ndërkombëtare, që i referohen sistemeve të menaxhimit të cilësisë, pra, të strukturave të organizimit të ndërrmarjeve publike dhe private, struktura të cilat këto ndërrmarje duhet t’i adoptojnë për një orientim më të mirë të ndërrmarjes në standartet e tregut. AK gjykon se çdo Ofertues duhet të jetë i pajisur me ISO 9001:2015 me qëllim efektivitetin dhe efektshmërinë në zhvillimin e veprimtarisë së tij, e cila do të sjellë dhe zvogëlimin e kostove. Pra ky çertifikim do të bëjë të mundur që Ofertuesit të ofrojnë cilësi të mirë me çmime të ulta.

ISO 14001:2015 / ekuivalente ofron një kuadër praktik për shoqëritë që duan të menaxhojnë rreziqet mjedisore ekzistuese dhe potenciale. Ky sistem integrohet lehtësisht në strukturën e menaxhimit të biznesit për të kontrolluar impaktet që aktivitetet, operacionet, produktet dhe shërbimet kanë mbi mjedisin. AK gjykon se çdo Ofertues duhet të jetë i pajisur me ISO 14001:2015 me qëllim që veprimtaria e ushtruar nga ana tije (në rastin konkret realizimi i punës objekt prokurimi) të identifikojë impaktin në mjedis gjatë aktivitetit të saj si dhe të përmirësojë performancën mjedisore duke zbatuar një qasje sistematike. Pra ky çertifikim do të bëjë të mundur që Ofertuesit të ushtrojnë veprimtarinë duke pasur në konsideratë parimin e mbrojtjes së mjedisit.

ISO 45001-2018/45001-2023 / ekuivalente është standard ndërkombëtarë, i cili parashton kërkesat për menaxhimin e praktikave të mira të sigurisë dhe shëndetit në punë për çdo organizatë, pavarësisht nga madhësia. AK gjykon se çdo Ofertues duhet të jetë i pajisur me ISO 45001-2018 ose ISO 45001-2023 ose me qëllim që veprimtaria e ushtruar nga ana tije (në rastin konkret realizimi i punës objekt prokurimi) të realizohet duke u mbështetur mbi parimin e sigurisë dhe shëndetit në punë. Kjo kërkesë shërben dhe si një

garanci extra që do të sjellë reduktimin e aksidenteve dhe sëmundjeve në vendin e punës duke minimizuar kostot si dhe kohën në përmbushjen me sukses të kontratës së punës objekt prokurimi.

ISO 50001-2018/ ekuivalente është standart ndërkombëtar, i cili specifikon kërkesat e përgjithshme për krijimin e një Sistemi të Menaxhimit të Energjisë në një organizatë dhe fokusohet në identifikimin e mundësive për përmirësimin e performancës së energjisë. ISO 50001 përcakton synimet dhe objektivat specifike për kursimin e energjisë, të cilat arrihen përmes programeve për menaxhimin e energjisë dhe monitorimin sistematik të variablave të energjisë.

Në VKM Nr. 285 datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” (e ndryshuar), Kreu XI, Neni 88, pika 3, cilësohet se: “Secili prej anëtarëve të këtij bashkimi duhet të përmbushë kërkesat e parashikuara në nenin 76 të LPP dhe ato të përcaktuara në dokumentet e tenderit. Kërkesat për kualifikim ekonomike, financiare, profesionale dhe ato teknike duhet të përmbushen nga i gjithë bashkimi, në përputhje me përqindjen e pjesëmarrjes në punë, shërbim apo furnizim, të përcaktuara në akt marrëveshje”. Për sa më lart, Njësia e Prokurimit, gjykon se, kjo kërkesë në rastet e Bashkimit të Operatorëve ekonomik duhet të përmbushet nga Shoqëria e cila referuar Marrëveshjes së Bashkëpunimit ka marrë përsipër të realizojë zerat e parashikuara sipas Preventivit.

AK gjykon se kërkesa për pajisjen e Ofertuesve me Çertifikatat e kërkuara sipas pikës 2.3.10 gërma “a”-“d”, është brenda kuadrit të parashikuar nga legjislacioni për prokurimin publik. Çertifikatat e kërkuara janë në përputhje me objektin e kontratës dhe respektojnë natyrën e punimeve.

2.3.11 Dëshmi për mjetet e pajisjet teknike, që ka në dispozicion apo mund ti vihen në dispozicion operatorit ekonomik, që nevojiten për ekzekutimin e kontratës (Shtojca 8) konkretisht:

Nr	Emri i mjetit	Njesi	Sasi/cope	Statusi
1	Kamion vetëshkarkues me kapacitet mbajtës jo më pak se 20 ton	copë	1	Në pronësi ose me qera
2	Kamion vetëshkarkues me kapacitet mbajtës 10-20 ton	copë	1	Në pronësi ose me qera
3	Kamionçinë me kapacitet mbajtës min 1.5 ton	copë	1	Në pronësi ose me qera
4	Sondë për shpime pilotash	copë	1	Në pronësi ose me qera
5	Eskavator me goma	copë	1	Në pronësi ose me qera
6	Fadromë	copë	1	Në pronësi ose me qera
7	Minifadrome /Bobcat	copë	1	Në pronësi ose me qera
8	Grejder	copë	1	Në pronësi ose me qera
9	Rrul për ngjeshjen e shtresave	copë	1	Në pronësi ose me qera
10	Kamion me vinc	copë	1	Në pronësi ose me qera
11	Autovinc	copë	1	Në pronësi ose me qera
12	Elektroorgano	copë	1	Në pronësi ose me qera

13	Autobetoniere	copë	4	Në pronësi ose me qera
14	Pompe betoni / Autopompe betoni	copë	1	Në pronësi ose me qera
15	Paisje gjeodezike Total Station	copë	1	Në pronësi ose me qera
16	Nivelues topografik me laser	copë	1	Në pronësi ose me qera
17	Kontenier ndertimi stacionar (zyre)	copë	1	Në pronësi ose me qera
18	Elektrobetoniere/Betoniere	copë	1	Në pronësi ose me qera
19	Gjenerator / Motogjenerator	copë	1	Në pronësi ose me qera
20	Pompe Suvatimi	copë	1	Në pronësi ose me qera
21	Depozite uji min ne 5000 litra	copë	1	Në pronësi ose me qera
22	Vibrator betoni	copë	3	Në pronësi ose me qera
23	Elektrosaldatrice/Motosaldatrice/Saldatrice	copë	1	Në pronësi ose me qera
24	Makineri per prerje hekur ndertimi	copë	1	Në pronësi ose me qera
25	Makineri per kthim hekur ndertimi	copë	1	Në pronësi ose me qera
26	Fabrike Betoni, pajisur me leje mjedisore nga QKL	copë	1	Në pronësi ose me qera ose kontratë furnizimi
27	Pompë uji	copë	1	Në pronësi ose me qera
28	Armatura	M2	1000	Në pronësi ose me qera
29	Skela	M2	1000	Në pronësi ose me qera

Për përmbushjen e këtij kriteri, operatorët ekonomikë duhet të vetëdeklarojnë mjetet dhe pajisjet që disponojnë në formularin përmbledhës të vetëdeklarimit Nr. 8 të DST.

- a)** Për mjetet në pronësi duhet të paraqitet: dokumenti që verteton regjistrimin e mjetit (leje qarkullimi), plus certifikaten e kontrollit teknik, siguracionin e mjetit (te vlefshme).
- b)** Për mjetet e deklaruara me qera duhet të paraqitet: kontrata përkatëse noteriale e qerasë e cila duhet të jetë e vlefshme, dokumenti që verteton regjistrimin e tij (leje qarkullimi), plus certifikaten e kontrollit teknik, siguracionin e mjetit, certifikatë për transport mallrash (e vlefshme).
- c)** Për mjetet që nuk shënohen në regjistra publike duhet të paraqiten dokumentat që vërtetojnë pronësinë e tyre, apo marrjen me qira të tij.
- d)** Operatori ekonomik duhet të paraqesë foto për secilin mjet të deklaruar ku të jetë e dukshme dhe targa e mjetit.

Autoriteti Kontraktor ka të drejtë të kryejë verifikimet e nevojshme mbi vërtetësinë e informacionit të deklaruar nga operatori ekonomik si më sipër, ose t'i kërkojë operatorit sqarime dhe dokumente mbështetëse për këto sqarime, në përputhje me Nenin 26, pika 7, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 "Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik".

Argumentimi: Në bazë të pikës 4, të nenit të 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 39, pika 6/ç dhe 6/d, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë fuqinë minimale punëtore, të nevojshme për ekzekutimin e objektit të prokurimit, si dhe mjetet e pajisjet teknike, të nevojshme për ekzekutimin e objektit të prokurimit, që ka në dispozicion apo që mund t’i vihen në dispozicion operatorit ekonomik për të përmbushur kontratën.

Për të përcaktuar numrin e mjeteve/makinerive të nevojshme për realizimin e kontratës, janë hartuar analizat teknike, sipas legjislacionit të fushës bazuar në VKM nr. 216, datë 13.4.2023 “Për krijimin dhe funksionimin e sistemit të integruar për informatizimin e manualit të çmimeve për zërat e punimeve në ndërtim”

Numri dhe lloji i makinerive, paisjeve në pronësi / qira janë vlerësuar si të nevojshme në përpjesëtim me natyrën dhe përmasat e kontratës, duke i’u referuar punimeve sipas standardeve, grafikut, kohëzgjatjes së punimeve dhe specifikimeve teknike të projekt zbatimit. Për të zbatuar kontratën, operatorët ekonomikë duhet të përmbushin kapacitetet teknike të pajisjeve dhe aseteve të tjera fizike, për këtë janë përcaktuar edhe dokumentet konkrete që duhet të paraqesin ofertuesit. Nëpërmjet kapaciteteve teknike operatorët ekonomikë vërtetojnë se zotërojnë aftësinë dhe kualifikimet e nevojshme teknike, profesionale, kapacitetet organizative, makineritë, pajisjet e asete të tjera fizike, aftësitë organizative. Pajisjet dhe mjetet e mësipërme janë të lidhura ngushtë me objektin e kontratës dhe i shërbejnë autoritetit kontraktor për njohjen e kapaciteteve dhe të mundësisë së operatorit për përmbushjen me sukses të kontratës si dëshmi për mjetet dhe pajisjet sipas specifikave.

II. Argumentimi i specifikimeve teknike

Specifikimet teknike , për realizimin e objektit prokurimi, përlllogaritja e fondit limit janë përcjellë pranë OBP, të hartuara nga grupi i punës i caktuara nga titullari i autoritetit kontraktor “**Enti Kombëtar i Banesave**”, dhe projekti i hartuar nga projektuesi për nevojat e së cilit, Operatori i Blerjeve të Përqëndruara, në cilësinë e Organit Qendror Blerës kryen procedurën e prokurimit, në zbatim të Ligjit nr. 162/2020 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar, VKM-në nr.531 datë 7.9.2023 “Për krijimin e shoqërisë aksionare shtetërore “Operatori i Blerjeve të Përqëndruara” Sh.a për kryerjen e procedurave të veçanta të prokurimit publik, në emër dhe për llogari të Kryeministritë, Ministrive dhe Institucioneve të Varësise”, i ndryshuar.

Në të gjitha rastet ku është përmendur fjala markë, Autoriteti Kontraktor do të pranojë edhe “ekuivalentin” e tij/tyre.

Në të gjitha rastet kur AK në specifikimet teknike i është referuar vetëm standarteve europiane, Autoritetit Kontraktor do të pranojë edhe paraqitjen e standarteve SSH/DIN/UNI/EN/ISO.

Të gjitha dokumentet duhet të jenë origjinale ose kopje të noterizuara.

Rastet e mosparaqitjes së një dokumenti, ose dokumente me të dhëna të rreme ose të pasakta, konsiderohen kushte për skualifikim.